

# Mekanizmat për Parandalimin e Torturës në Ballkanin Perëndimor Shqipëria, Mali i Zi dhe Serbia



Building free of torture and impunity  
societies in the Western Balkans




## MEKANIZMAT PËR PARANDALIMIN E TORTURËS NË BALLKANIN PERËNDIMOR Nën-raporti rajonal: SHQIPËRIA, MALI I ZI DHE SERBIA



*Building free of torture and impunity societies in the Western Balkans*  
An EU-funded project





**MEKANIZMAT PËR PARANDALIMIN E TORTURËS NË BALLKANIN PERËNDIMOR**  
**Nën-raporti rajonal:**  
**SHQIPËRIA, MALI I ZI DHE SERBIA**

**Qershor, 2016**

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (MNE), Këshilli Ndërkombëtarë i Rehabilitimit për Viktimat e Torturës (IRCT), Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës (QSHRT), Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (SR)

**Botues**

Edina Hasanaga Çobaj

**Autorë**

Mushegh Yekmalyan

Milan Antonijeviq

**Hulumtues**

Boris Raoniq

Milan Radoviq

Erinda Bllaca

Ivan Kutllaroviq

Marko Millosavljeviq

**Përkthimi**

Sabra Deceviq

**Dizajni**

Copy Center DOO, Podgorica

Nina Cvetkovski

**Shtypi**

Copy Center DOO, Podgorica

Каталогизација у публикацији  
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-9940-608-10-1

COBISS.CG-ID 31227664

Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e YIHR (MNE), IRCT, QSHRT dhe YIHR (SR) dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

## PËRMBAJTJA:

<b>SHKURTESAT .....</b>	<b>5</b>
<b>I HYRJE .....</b>	<b>6</b>
<b>II SHQIPËRIA .....</b>	<b>8</b>
2.1. Të dhënat e përgjithshëm mbi vendin .....	8
2.2. Korniza e aplikueshme ligjore– nga normat ndërkombëtare deri tek legjislati i vendit .....	9
2.2.1. Traktatet Ndërkombëtare .....	9
2.2.2. Anëtarësimi në Këshillë të Evropës .....	9
2.2.3. Dënimi me vdekje .....	10
2.2.4. Gjyqësia .....	10
2.2.5. Legjislati i vendit dhe ndalimi i torturës .....	11
2.3. Institucioni Kombëtar për të Drejtat e Njeriut, Mekanizmi Kombëtar Parandalues dhe mekanizmat e tjerë të monitorimit .....	12
2.3.1. Institucioni Kombëtar për të Drejtat e Njeriut - Avokati i Popullit .....	12
2.3.2. MKPT në Shqipëri .....	13
2.3.3. Mbikëqyrja e Prokurorisë .....	15
2.3.4. Roli i OJQ-ve .....	15
2.3.5. Organizatat ndërkombëtare .....	16
2.4. Përgjigje – Rastet e torturës .....	17
2.5. Vendet e privimit të lirisë .....	19
2.6. Fushat e shqetësimit .....	24
2.7. Rekomandimet .....	26
<b>III MALI I ZI .....</b>	<b>30</b>
3.1. Informacione të përgjithshme mbi vendin .....	30
3.2. Korniza e aplikueshme ligjore - nga normat ndërkombëtare deri te legjislati e vendit .....	30
3.2.1. Traktatet ndërkombëtare .....	30
3.2.2. Anëtarësimi në Këshillin e Evropës .....	31
3.2.3. Dënim me vdekje .....	31
3.2.4. Gjyqësia .....	31
3.2.5. Legjislati i vendit dhe ndalimi i torturës .....	32
3.3. Institucioni Kombëtar për të Drejtat e Njeriut (IKDNJ), Mekanizmi Kombëtarë Parandalues dhe mekanizmat e tjerë të monitorimit .....	33
3.3.1. IKDNJ - Avokati i Popullit .....	33
3.3.2. Mekanizmi Kombëtar Parandalues .....	33
3.3.3. Mekanizmat e tjerë monitorues .....	35
3.4. Përgjegje – Rastet e torturës .....	36
3.5. Vendet e privimit të lirisë .....	36

3.6. Fushat e shqetësimit .....	37
3.7. Rekomandimet .....	39
<b>IV SERBIA .....</b>	<b>41</b>
4.1. Informata të përgjithshme mbi vendin .....	41
4.2. Korniza e aplikueshme ligjore - nga normat ndërkombëtare tek ligjislacioni i vendit .....	43
4.2.1. Traktatet ndërkombëtare .....	43
4.2.2. Anëtarësimi në Këshillin e Evropës .....	44
4.2.3. Dënimi me vdekje .....	44
4.2.4. Gjyqësia .....	45
4.2.5. Legjislacioni i vendit dhe ndalimi i torturës .....	46
4.3. Institucioni Kombëtar për të Drejtat e Njeriut, Mekanizmi Kombëtar Parandalues dhe mekanizmat e tjerë për monitorim .....	48
4.3.1. Institucioni Kombëtar për të Drejtat e Njeriut – Avokati i Popullit .....	48
4.3.2. Mekanizmi Kombëtar Parandalues në Serbi .....	49
4.3.3. Mekanizmat e tjerë të monitorimit .....	51
4.4. Përgjigjet – Rastet e torturës .....	52
4.5. Vendet e privimit të lirisë .....	52
4.6. Fushat e shqetësimit .....	54
4.7. Rekomandimet .....	58
V QASJE RAJONALE DHE REKOMANDIMET MBI FUSHAT ME INTERES .....	61



## **SHKURTESAT**

QSHRT – Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës

KPT – Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës

OSHC – Organizatë e Shoqërisë Civile

BE – Bashkimi Evropian

IRCT – Këshilli Ndërkombëtarë i Rehabilitimit për Viktimat e Torturës

OJQ – Organizatë jo qeveritare

NHRI – Institucionl Nacional për të Drejtat e Njeriut

MKPT – Mekanizmat Kombëtare Parandaluese

OPCAT – Protokolli Opcional i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara

UPR – Rishikimi Periodik Universal

YIHR – Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut

YUCOM – Komiteti i Juristve për të Drejtat e Njeriut

## I HYRJE

Me miratimin e Protokollit Opsional të Kombeve të Bashkuara të Konventës kundër Torturës dhe Trajtitimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruar më 18 dhjetor të vitit 2002, komuniteti ndërkombëtar ka demonstruar vullnetin politik për t'iu përgjigjur një sfide globale me një përgjigje të gjerë globale, duke krijuar mekanizmat e qartë për reagim të shpejtë dhe të saktë.

Nëse shteti ligjor nuk është dobësuar vetëm në një vend, por në shumë vende, atëherë ato që e mbrojnë atë nuk mund të kufizohen vetëm në fondet nacionale, por duhet të punojnë së bashku, duke u përqëndruar në aspekte të ndryshme, e poashtu në ngjajshmëritë e luftës kundër torturës.

Për këtë shkak, ne zgjodhëm një qasje rajonale, duke mbuluar tre vende brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Ky raport është një ndër prodhimet e projektit të YIHR „Ndërtimi i një shoqërie pa tortura dhe pandëshkueshmëri në Ballkanin Perëndimor”, të financuar nga Bashkimi Evropian dhe e cila ka për qëllim të analizojë dhe përmbledh trendet në sistemin e mbrojtjes nga tortura në tre vende të ndryshme në Ballkanin Perëndimor. Vendet e përzgjedhura janë: Shqipëria, Mali i Zi dhe Serbia, dhe mund të numërojmë arsye të shumta për këtë fokus.

Ky raport vlerëson legjislacionin nacional, praktikat dhe përvojat e ekspertëve nacional në këtë fushë.

Pas përpilimit të metodologjisë së përbashkët, një pyetësor gjithpërfshirës u shpërnda tek partnerët në projekt në tre vendet e përzgjedhura. Përgjegjet initiale u komentuan dhe u kërkuan informata më të hollësishme nga ekspertët në projekt. Rezultatet e këtij procesi u mblodhën gjatë tremujorit të dytë të vitit 2016.

Historikisht, të gjitha vendet e përfshira në projekt kishin trashëgimi totalitare për shumë dekada dhe një numër problemesh, prandaj çështjet në fushën e të drejtave të njeriut gjithashtu i kanë rrënjët në ato kohë. Si rezultat, ato trashëgjuan sistemin e drejtësisë penale i cili ishte krijuar gjatë regjimit komunist, dhe i cili përfshinte legjislacionin, administratën dhe infrastrukturën e burgjeve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme: siç paraqesin analizat e mëposhtme, me karakteristikat e tyre të përbashkëta pasi që shtetet e periudhës post-komuniste akoma kanë një numër të ngjajshmërive në sistemin e tyre. Gjatë viteve të pavarësisë së tyre, të tre vendet kanë krijuar një formë të mekanizmit monitorues në kuadër të OPCAT. Gjatë periudhës së komunizmit, prokurorët kanë ushtruar monitorimin, ndërkohë që institucionet e Avokatit të popullit u krijuan në vitet 1990 dhe fillim të vitit 2000. Ngarkuar me mandate të gjëra, Avokatët e popullit patën vështirësi të përqendroheshin në monitorimin e kushteve të paraburgimit dhe parandalimin e torturës. Ky ishte rezultat ose i mungesës së kapacitetit apo interesimit për çështjet e tjera, apo hapsirës së punës, përfshirë këtu edhe faktorët politikë. Në shumicën e vendeve në synim, institucionet demokratike akoma mundohen të funksionojnë në mënyrë të pavarur dhe efektive, edhe pse gjatë 10 viteve të fundit është vërejtur progresi. Edhe në vendet me karakteristika të forta demokratike, organet e zbatimit të ligjit disi ishin kundë monitorimit publik dhe mbikqyrjes gjyqësore.



Krijimi i Mekanizmave Kombëtare për Parandalimin e Torturës<sup>1</sup> në këto shtete ndryshon shumë në kronologji, dhe mbetet akoma të shihet se si krijimi i Mekanizmave Kombëtar Parandalues (këtu e tutje MKPT) do të ndikojnë monitorimin e mekanizmave afat gjatë dhe të mesëm nga ana e shoqërisë civile përkatëse. Në shumë raste, ku institucionet demokratike, në përgjithësi, nuk janë zhvilluar sipas traditave më të mira të pavarësisë dhe paanshmërisë, sistemi Avokati i Popullit Plus i MKPT ende duket problematikë.

Në shumë raste, MKPT nuk konsiderohen të jenë aq efektive si në vendet e tjera për sa i përket paanshmërisë dhe raportimit të besueshëm. Krijimi i nivelit të dyfishtë të monitorimit (MKP-të në nivelin kombëtarë dhe OKB SPT në nivelin ndërkombëtarë) të vendeve të privimit të lirisë u mendua si një ide e mirë për përmirësimin e sistemit të parandalimit të torturës. Megjithatë, realiteti pas 10 viteve të implementimit të OPCAT tregon se luftarët kundër torturës dhe autorët e torturës janë në betejë të vazhdueshme me njëri tjetrin. Në shumë raste, qeveritë kombëtare bëhen më „kreative“ në mëshejen e torturave pas retorikës populliste dhe, si rezultat, MKPT bëhen më pak efektive dhe shpesh jofunksionale. Pas krijimit të MKPT, duhet të angazhohen fonde dhe resurse për funksionimin e duhur dhe, për fat të keq, ky nuk është rasti në të gjitha vendet.

Ky raport synon të vlerësoj, në një perspektive komparative, kornizën legjislative dhe kushtet e paraburgimit para se të fokusohet në ankesat dhe mekanizmat e monitorimit në të gjithë rajonin, me theks të veçantë në themelimin e Mekanizmave Kombëtare Parandaluese në kuadër të OPCAT.

Gjithashtu kemi veçuar praktika të mira nga disa vende, duke theksuar se sistemi është akoma në zhvillim e sipër dhe se hapat e parë janë duke treguar rezultate premtuese. Konkluzionet dhe rekomandimet specifike të vendit ndërlidhen me rekomandimet për rajonin në tërësi. Për këtë arsye, jemi përpjekur të kemi rekomandime në nivel të çdo vendi në fokus, me konkludime specifike në fund mbi ngjajshmëritë dhe zbatueshmërinë e secilit rekomandim në rajon si tërësi.

---

1 Krijur nën kujdesin e OPCAT

## II SHQIPËRIA

### 2.1. Të dhënat e përgjithshëm mbi vendin

Shqipëria është Republikë Parlamentare e themeluar në bazë të kushtetutës së re të vitit 1998. Shqipëria është vend me histori të gjatë të regjimit totalitarë, dhe vetëm pas protestave të vitit 1989 dhe reformave të qeverisë komuniste në vitin 1990, Republika e Popullit<sup>2</sup> është shpërbërë gjatë viteve 1991-92 dhe u themelua Republika e Shqipërisë. Komunistët mbajtën një pozitë të fortë në parlament pas mbështjes popullore në zgjedhjet e vitit 1991. Megjithatë, në mars të vitit 1992, pas liberalizmit që rezultoj në një kolaps ekonomik dhe trazira sociale, pushtetin e mori një front i ri i udhëhequr nga Partia e re Demokratike.

Në vitet në vijim, pjesa më e madhe e akumuluar e pasurisë së vendit u investua në Ponzi skemat piramidale bankare, të cilat janë mbështetur gjerësisht nga zyrtarët qeveritarë. Skemat përfshinë diku nga një të gjashtën deri një të tretën e popullsisë së vendit. Megjithë paralajmërimet e FMN-së në fund të vitit 1996, presidenti i atëhershëm Sali Berisha mbrojt skemat si firmat e mëdha investuese, duke shtyrë shumë njerëz të i drejtojnë kursimet e tyre dhe të shesin shtëpitë dhe bagëtinë e tyre për të holla për të depozituar në skemat. Skemat filluan të rrëzohen në fund të vitit 1996, duke shtyrë shumë prej investitorëve në protesta. Protestat kundër qeverisë fillimisht ishin paqësore dhe investitorët kërkonin paratë e tyre mbrapa. Protestat u bënë të dhunshme në shkurt pasi forcat qeveritare u përgjigjën me zjarr. Në mars, policia dhe Garda e Republikës ikën dhe i lanë depot e armëve të hapura, të cilat më pas u zbrazën menjëherë nga milicia dhe bandat kriminale. Kriza e rezultuar shkaktoi një valë të evakuimeve të shtetasve të huaj dhe refugjatëve.

Kriza e shtyri Kryeministrin Aleksandër Meksi të jap dorëheqjen me 11 mars të vitit 1997, pastaj dhe Presidentin Sali Berisha në korrik në prag të zgjedhjeve të përgjithshme të qershorit. Në prill më 1997, Operacioni Alba, një forcë paqeruajtëse e OKB-së e udhëhequr nga Italia, hyri në vend me dy qëllime: të ndihmojë evakuimin e emigrantëve dhe të sigurojë terrenin për organizatat ndërkombëtare. Së pari kjo ishte WEU MAPE, e cila punoi bashkë me qeverinë në ristrukturimin e sistemit gjyqësor dhe policisë. Partia socialiste fitoi në zgjedhjet e vitit 1997, dhe më pas u siguroi një nivel i caktuar i stabilizimit politik.

Në vitin 1999, vendi u ndikua nga lufta në Kosovë, kur një numër i madhë i Shqiptarëve nga Kosova gjetën strehim në Shqipëri.

Shqipëria u bë anëtare e plotë e NATO-s në vitin 2009, dhe ka aplikuar për antarësim në Bashkimin Evropian. Më 2013, Partia socialiste fitoi zgjedhjet nacionale. Në qershor të vitit 2014, Republika e Shqipërisë u bë kandidatë zyrtare për antarësim në Bashkimin Evropian. Shqipëria kufizohet me Greqinë, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Kosovën. Sipas të dhënave nga regjistrimi i fundit në vitin 2011, popullsia totale e Shqipërisë është 2,821,977.

Sipas regjistrimit të vitit 2011, popullsia e Shqipërisë ka deklaruar përkatësinë e mëposhtme etnike: Shqiptarë 2,312.356 (total 82.6%), Grekë 24,243 (0.9%), Maqedonas 5,512 (0.2%), Malazez 366 (0.01%), Arumunë 8,266 (0.30%), Romë 8,301 (0.3%), Egjiptianët e Ballkanit 3,368 (0.1%), etnitë e tjera 2,644 (0.1%), pa deklaruar etnike 390,938 (14.0%), dhe jo relevant 44,144 (1.6%).<sup>3</sup>

2 Regjimi komunist ishte në pushtet në Shqipëri përmbi 45 vjetë

3 [http://www.instat.gov.al/media/178070/rezultatet\\_kryesore\\_t\\_censusit\\_t\\_popullsis\\_dhe\\_banesave\\_2011\\_n\\_shqip\\_ri.pdf](http://www.instat.gov.al/media/178070/rezultatet_kryesore_t_censusit_t_popullsis_dhe_banesave_2011_n_shqip_ri.pdf)

## 2.2. Korniza e aplikueshme ligjore– nga normat ndërkombëtare deri tek legjislati i vendit

### 2.2.1. Traktatet Ndërkombëtare

Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar konventat dhe traktatet e mëposhtme ndërkombëtare:

Në kuadër të angazhimeve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, Republika e Shqipërisë ka nënshkruar dhe ratifikuar shumicën e konventave dhe protokolleve ndërkombëtare të OKB-së dhe Këshillit të Evropës, si dhe një numër të marrëveshjeve bilaterale në fushën penale.

- Konventa mbi parandalimin dhe dënimin e krimit, e miratuar më 12 maj 1995;
- Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, hyrë në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 11 maj 1994;
- Konventa për mos parashkrimin e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, hyrë në fuqi më 19 maj 1971;
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës, hyrë në fuqi më 11 maj 1994;
- Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale, Romë 18 korrik 1998, ratifikuar më 23 dhjetor 2002;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, të nënshkruar më 12 dhjetor 2000;
- Protokollin për Parandalimin, Shtypjen dhe Ndëshkimin e Trafikut të Personave, veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve, që shton Konventën e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, ratifikuar më 12 dhjetor 2000;
- Protokollin kundër Trafikimit të emigrantëve nga Toka, Deti dhe Ajri që shton Konventën e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, ratifikuar më 12 dhjetor 2000;
- Statuti i Këshillit të Europës u ratifikua dhe hyri në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 13.7.1995
- Konventa „Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”, u nënshkrua më 13.07.1995, dhe u ratifikua dhe hyri në fuqi më 02.10.1996.

Shqipëria gjithashtu ka ratifikuar edhe protokollin shtesë nr. 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8, të kësaj Konvente të cilat janë nënshkruar, ratifikuar dhe hyrë në fuqi gjithashtu më 02.10.1996. Protokollin 11 i Konventës Evropiane „Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” është nënshkruar më 13.07.1995, ratifikuar më 02.10.1996 dhe hyrë në fuqi më 01.11.1998.

### 2.2.2. Anëtarësimi në Këshillë të Evropës

- Shqipëria u bë shtet anëtarë e Këshillit të Evropës me 10 korrik të vitit 1995.
- Shqipëria ratifikoi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vitin 1996.

### 2.2.3. Dënimi me vdekje

Protokoli i gjashtë Opsional i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, lidhur me heqjen e dënimit me vdekje, është nënshkruar me 4 prill të vitit 2000, ratifikuar më 21 shtatorë të vitit 2000, dhe hyri në fuqi me 1 tetorë të vitit 2000.

Që me 1992, kur u ekzekutua dënimi i fundit me vdekje, dënimi me vdekje u përcaktua në kodin penal, por zbatimi i këtij dënimi u pezullua. Pas ratifikimit të Protokolit të gjashtë Opsional të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ky dënim u zëvendësua me burgim të përjetshëm. Protokolet e dymbëdhjetë dhe trembëdhjetë Opsional të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore janë në proces të ratifikimit.

### 2.2.4. Gjyqësia

Sipas nenit 42/2 të Kushtetutës, çdo person, në mënyrë që të mbrojtë të drejtat e tij/saj kushtetuese dhe ligjore, liritë dhe interesat, ose në rastin e akuzave kundër tij/saj, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Përveç kësaj, Neni 43 dhe Neni 44 i Kushtetutës garanton se çdo person ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. Çdo person ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, nëse ai/ajo ka pësuar dëme për shkak të një akti jo ligjor, veprimi ose dështim të veprimit nga ana e zyrtarëve publikë.

Neni 48 parashikon që të gjithë, që veprojnë vetë apo me të tjerët, mund të paraqesin kërkesa, ankesa apo vërejtje zyrtarëve publikë, të cilët nga ana tjetër detyrohen të kthejnë përgjigje gjatë një periudhe të caktuar kohe dhe sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

Organizimi i sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë është dhënë në pjesën e nëntë të Kushtetutës, nenet 135-147. Sipas nenit 135, pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, e poashtu edhe nga gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së pare, të themeluara me ligj. Kuvendi mund të krijoj me ligj Gjykata për fusha të veçanta, por në asnjë rast Gjykata të Jashtëzakonshme.

Për më tepër, Ligji nr. 8436 i 28 dhjetorit të vitit 1998 „Mbi organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” parasheh organizimin e sistemit gjyqësor, të ndryshuar me Ligj nr. 8546 të dates 5 nëntor të vitit 1999 dhe me Ligjin nr. 8656 me datë 31 korrik të vitit 2000.

Struktura hierarkike e gjykatave

Nenet 135 - 145 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë sigurojnë kornizën themelore për organizimin e sistemit të gjykatave. Këto dispozita, së bashku me ligjet në fuqi kanë ngritur sistemin e mëposhtëm:

#### GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË:

- **Gjykatat e rrethit** kanë juridiksion fillestar edhe për raste penale (me përjashtim të krimeve të rënda) dhe ato civile (duke përjashtuar konfliktet administrative). Juridiksioni i tyre territorial shtrihet në qarqet përkatëse.
- **Gjykata e shkallës së parë për krime të rënda** merret me krime të rënda dhe ka juridiksion territorial në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
- **Gjykata administrative e shkallës së parë** – ekzistojnë 6 gjykata që merren me mosmarrëveshtjet administrative ligjore, secili përgjegjës për qarkun përkatës. [4]

#### GJYKATAT E APELIT:

- **Gjykata e apelit**, e cila mund të shqyrtojë vendimet e gjykatave më të ulta për rastet penale (me përjashtim të krimeve të rënda) dhe ato civile (duke përjashtuar konfliktet administrative). Juridiksioni i tyre territorial shtrihet në zona të caktuara nga Presidenti i Shqipërisë.
- **Gjykata e Apelit për krime të rënda**, i dëgjon ankesat për krime të rënda dhe ka juridiksion territorial në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
- **Gjykata administrative e apelit**, i ndëgjon ankesat për mosmarrëveshtjet administrative ligjore dhe ka juridiksion territorial në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. [6]

#### GJYKATAT MË TË LARTA:

- **Gjykata e Lartë e Shqipërisë**, dëgjon ankesat përmes Dhomës Civile, Dhomës Penale dhe Dhomës Administrative. Në rastet e kompleksitetit të madh apo kur jep një vendim unifikues për të gjithë gjykatat e shkallëve më të ulta për tu ndjekur, Gjyqtarët e Gjykatës së lartë mbajnë gjykatë si pjesë e Dhomës së unifikuar. [7]
- **Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë**, interpreton Kushtetutën dhe dëgjon rastet në lidhje me abuzimet e pretenduara të të drejtave të njeriut.

### 2.2.5. Legjislacioni i vendit dhe ndalimi i torturës

#### Kushtetuta

Të drejtat e njeriut dhe liritë janë dhënë në pjesën e dytë të Kushtetutës (nenet 15-63). Dispozitat kryesore ligjore në lidhje me mbrojtjen kundër torturës dhe dënimeve ose trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore apo degraduese janë të përcaktuara në nenin 25 të Kushtetutës: „Askush nuk mund t’i nënshtrohet tortures, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtrues”.

Neni 122 i Kushtetutës siguron marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara statusin vetëm-ekzekutiv në ligjin kombëtarë. Pasi që sipas UNCAT përcaktimi i torturës dhe kriminalizimit nuk është e specifikuar në detaje të mjaftueshme në Kushtetutën, Konventa nuk është e kënaqur. Neni 44 garanton kompensim për ata që pësuan dëme në bazë të veprimit të paligjshëm apo mosveprimit nga ana e zyrtarëve publikë apo organeve.



Sipas nenit 4 të Kushtetutës, ligji përcakton bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Në mënyrë të ngjashme, neni 15/1 parashikon se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.

### **Kodi penal**

Tortura dhe trajtimi çnjerëzor apo degradues përmenden në një numër të neneve të Kodit penal të Shqipërisë. Përkufizimi i torturës është dhënë në nenin 86 të Kodit penal dhe është në përputhje me përkufizimin e torturës në Konventën kundër torturës siç është formuluar në nenin 1. Nenet 58 dhe 59 të Kodit penal përcaktojnë të drejtat e viktimës të kërkojë ndjekje dhe kompensim nga kryesit dhe hap mundësinë që viktima të marrë pjesë si pale në çështjen penale. Tortura gjithashtu gjindet në nenet 74, 76 dhe 109a, 109b të Kodit penal.

## **2.3. Institucioni Kombëtar për të Drejtat e Njeriut, Mekanizmi Kombëtar Parandalues dhe mekanizmat e tjerë të monitorimit**

### **2.3.1. Institucioni Kombëtar për të Drejtat e Njeriut - Avokati i Popullit**

Institucioni i Avokatit të Popullit është parashikuar për herë të parë në Kushtetutën Shqipëtare të miratuar në nëntor të vitit 1998, gjersa Ligji nr. 8454 „Për Institucionin e Avokatit të Popullit” (e ndryshuar më pas) u miratua së pari nga Parlamenti Shqiptarë me 4 shkurt të vitit 1999. Ky ligj mori në konsiderim legjislaturën e shteteve të tjera Evropiane sa i përket institucionit të Avokatit të popullit. Avokati i popullit zgjedhet nga tri të pestat e shumicës së Kuvendit kombëtarë për një periudhë 5 vjetësh me të drejtë rizgjedhjeje. Sipas OPCAT (miratuar në bazë të ligjit nr. 9094, datë 03.07.2003), Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës ushtron aktivitetet në bazë të një sërë aktesh të brendshme, ku dy nga më të rëndësishmet janë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 8454, datë 04.02.1999 „Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Këto dispozita parashikojnë parimet bazë të inspektimit të objekteve të paraburgimit dhe garantojnë një aktivitet në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare, ndërsa neni 19/1 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 „Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, autorizon një monitorim të pavarur dhe gjithëpërfshirës dhe aktivitet hetimi për çdo rast të torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues, duke u siguruar të gjithë zyrtarëve një qasje më të gjerë në të gjithë ambientet pa imunitet, si dhe çdo dokumentacioni, edhe të klasifikuar, të organeve të administratës publike.<sup>4</sup>

Për më tepër, ndryshimet e tjera me ligj nr. 9888, date 10.03.2008, ligji nr. 8328 datë 02.04.1998 „Mbi të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, sigurojnë liri shtesë për Avokatin e Popullit si Mekanizëm Kombëtarë për Parandalimin e Torturës (MKPT) për të kryer detyrat gjatë kontrollit të shërbimeve të vuajtjes së dënimit.

<sup>4</sup> Korniza ligjore e MKPT Shqipëri është në dispozicion në: <http://www.avokatipopullit.gov.al/en/kuadri-ligjor>, herën e fundit e vizituar në maj, 2016



Neni 74/1 i këtij ligji i jep Avokatit të Popullit, përmes MKPT, të drejtën të mbikqyr zbatimin e ligjit për të burgosurit dhe paraburgosurit si një entitet të veçantë. Zyra e Avokatit të Popullit lejohet të monitoroj rregullisht trajtimin e personave të privuar nga liria në hapsirat e burgimit, arrestimin, me qëllim të fuqizimit, nëse është e mundëshme, të mbrojtjes së këtyre personave nga tortura, trajtimi apo dënimi mizor apo çnjerzorë. Sipas kësaj dispozite, kjo Zyra ka të drejtë të paraqesë në mënyrë specifike raporte dhe rekomandime tek organet përkatëse, me qëllim të përmirësimit të trajtimit dhe kushteve të burgosurve dhe të parandalojë torturat, dënimet dhe trajtimet e tjera mizore, çnjerzore apo degraduese.

### 2.3.2. MKPT në Shqipëri

Republika e Shqipërisë ka nënshkruar Protokollin Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Dënimeve të tjera Çnjerzore dhe Degraduese (OPCAT),<sup>5</sup> dhe e ka miratuar atë në bazë të ligjit nr. 9094, datë 03.07.2003, duke i dhënë kompetenca Avokatit të Popullit për të vepruar në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin kundër Torturës.<sup>5</sup>

Në mënyrë që të përshkruhet MKPT Shqiptarë, mund të mbështetemi tek të dhënat të përfshirë në prezantimin zyrtarë të Avokatit të popullit: „Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka të bëjë me kryerjen e inspektimeve dhe vizitave në mjediset ku individët janë të privuar nga liria me qëllim të parandalimit të rasteve të torturës ose dënimeve të tjera çnjerzore ose degraduese. Kjo strukturë është ngritur në bazë të „Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe dënimeve të tjera Çnjerzore dhe degraduese” (OPCAT) ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë, Ligji nr. 9094, datë 03.07.2007”.

Në përputhje me OPCAT, në fillim të vitit 2008, Kuvendi i Shqipërisë ia ka dorëzuar Avokatit të Popullit (AP) funksionin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin kundër Torturës (MKPT) në bazën të një ligji të veçantë. Ratifikimi i OPCAT dhe krijimi i MKPT Shqiptarë mbetet një histori suksesi e cila u iniciua si bashkëpunim në mes të shoqërisë civile dhe AP nën moton „Shqipëria pa torturë”.<sup>6</sup>

Njësia e Parandalimit të Torturave u krijua në kuadër të Zyrës së Avokatit të Popullit në janar të vitit 2008 për të marrë mandatin e MKPT. Njësia për Parandalimin e Torturës raporton direkt Avokatin e Popullit. Sipas Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2009, Njësia për Parandalimin e Torturës bashkëpunon me pjesët e tjera të institucionit.

Në qershor të vitit 2009, Avokati i Popullit ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me tre organizata joqeveritare. Në raste të caktuara, janë kryer vizita të përbashkëta në vende të veçanta të paraburgimit. Njësia për Parandalimin e Torturës është mbështetur në ekspertizën specifike nga organizatat e mëposhtme:

- Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Viktimave, e cili siguron ekspertizë mjeko-ligjore për MKPT Shqiptare;
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit, i cili siguron ekspertizë të punës psikologjike dhe sociale për MKPT Shqiptare; dhe

5 [http://www.apr.ch/en/opcat\\_pages/npm-designation-2/](http://www.apr.ch/en/opcat_pages/npm-designation-2/)

6 Raporti i BE mbi progresin në Shqipëri, 2008, seksioni mbi të drejtat civile dhe politike, faqja 12

- The Instituti European i Tiranës, i cili siguron ekspertizë psikologjike, mjeko-ligjore dhe psikiatrike për MKPT Shqiptare.

Është raportuar se, në vitin 2009, Instituti European i Tiranës ka shoqëruar MKPT në të gjitha vizitat në qendrat e paraburgimit.

Avokati i Popullit raportoi se nuk u janë dhënë burime financiare shtesë për të kryer aktivitetet e MKPT-së përveç se pesë anëtarë shtesë të stafit të MKPT-së. Për këtë arsye aktivitetet e MKPT-ës janë kryer në kuadër të buxhetit të përgjithshëm të Avokatit të Popullit, në kundërshtim me detyrimet e vendit siç është përcaktuar në OPCAT.

Si përkujtim, në vitin 1994 Shqipëria ratifikoi Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerzore ose poshtuese (UNCAT) dhe në vitin 1996, Shqipëria ratifikoi Konventën Evropiane për Parandalimin e Torturës (KPT). Siç u përmend edhe më parë, Shqipëria gjithashtu ratifikoi Protokolin Opsional të UNCAT (OPCAT) në vitin 2003. Shqipëria dorëzoi raportin e parë fillestar Komitetit kundër Torturës (CAT) në vitin 2003 dhe pati një seancë të veçantë në Rishikimi Periodik Universal (UN UPR) në dhjetor të vitit 2009. Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) i Këshillit të Evropës vizitoi Shqipërinë 11 herë, vizita e fundit ndodhi në vitin 2014.<sup>7</sup>

Protokolli Opsional i Konventës së OKB-së Kundër Torturës dhe Dënimeve të tjera Çnjerzore dhe Degraduese (OPCAT), parashikon futjen e skemave të pavarura monitoruese në vendet e parandalimit. Protokolli Opsional i Konventës së OKB-së kundër Torturës (OPCAT) parashikon ngritjen e një Mekanizmi Kombëtarë për Parandalimin e Torturës (MKPT) e fuqizuar në bazë të dispozitave ligjore për parandalimin e torturës përmes vizitave të paparalajmëruara në çdo vend të paraburgimit.

Qasja preventive e përcaktuar në Protokollin Opsional është e bazuar në monitorimin e rregullt dhe periodik të vendeve të paraburgimit, përmes vizitave të kryera nga organet e ekspertëve me qëllim të parandalimit të abuzimit.

Që nga themelimi i saj, MKPT Shqiptarë është sfiduar nga mungesa e ekspertizës profesionale multi-disiplinore, mungesa e burimeve financiare, si dhe mungesa e metodologjive të monitorimit, të cilat u minimizuan përmes bashkëpunimit me organizata profesionale që ofrojnë ekspertët mjekësore, psikologjikë dhe psikiatrikë të bashkangjiten vizitave monitoruese. Si rezultat, MKPT me mbështetjen nga OSHC-të është bërë funksionale dhe vazhdon të rris fushën e punës dhe aktivitetet në vende të ndryshme të paraburgimit me qëllim të implementimit të OPCAT.

Në ditët e sotme, MKPT është duke përjetuar kthimin e stafit: ndryshimet kanë ndikuar në pozicionin e kreu të zyres dhe shumicën e stafit monitorues. Edhe pse pa një Memorandum Mirëkuptimi, QSHRT ka venë theks të madhë në vizitat parandaluese monitoruese në vendet e paraburgimit – përmes një metodologjie mirë të definuar dhe instrumenteve të shqyrtimit të standardeve për sa i përket mbledhjes së të dhënave dhe analizës së tyre.

---

<sup>7</sup> <http://www.cpt.coe.int/en/states/alb.htm>

Edhe pse AP kryen shumë vizita në vendet e paraburgimit, nuk ka një sistem konsistent dhe gjithëpërfshirës të vizitave, i cili do të mund të klasifikojë vizitat si inspektime të plota, periodike dhe të rregullta, ose ad-hoc. Gjithashtu, ndërsa nuk ka kriteret e përgjithshme mbi zgjatjen dhe shpeshtësinë e vizitave të plotë. Duke pasur parasysh kapacitetin e vendeve të paraburgimit që ekzistojnë në Shqipëri, vizitat e plotë të inspektimit duhen të zgjasin minimum dy ditë dhe të kryhet të paktën dy herë në vit.

Ndryshimet e reja legislative janë pritur të ndodhin në lidhje me funksionimin më të mirë të Zyrës së Avokatit të Popullit, edhe pse nuk u organizuan diskutime publike lidhur me këto ndryshime.

### **2.3.3. Mbikëqyrja e Prokurorisë**

Në burgjet e sigurisë së lartë, inspektimet kryejnë prokurorët të autorizuar nga Prokurori i Përgjithshëm. Në të gjitha kategoritë e institucioneve të zbatimit të ligjit dhe rregulloreve përkatëse, kontrollin e bën Këshilli i Inspektimit, i themeluar me Ligjin „Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Bazuar në një kërkesë apo pretendim, Këshilli i Inspektimit ka të drejtë të bëjë të gjitha verifikimet e nevojshme, dhe në bazë të sajë, ai mund të kërkojë ndërmarrjen e veprimeve nga kreu i institucionit, ose të i rekomandojë prokurorit që të ushtroj kompetencat ose që të paraqesë kërkesat drejtpërdrejt në gjykatën kompetente.

Prokurori duhet të vëzhgoj drejtpërdrejt, periodikisht ose pa paralajmërim institucionet e vuajtjes së dënimit, i shoqëruar, kur është e nevojshme, nga specialistë të fushave përkatëse. Lidhur me gjetjet e tij, si dhe të parregullsive dhe pengesave që ka takuar gjatë procedurës, prokurori i paraqet kërkesë kreu të institucionit, me qëllim të rivendosjes së ligjit apo rregullave të shkelur, arritjen e të drejtave të personit të dënuar, si dhe inicimin e procedurës disiplinore, administrative apo kompenzuese, përveç nëse rrethanat kërkojnë fillimin e procedurës penale.

Neni 1 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se „... Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojtë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit.”

### **2.3.4. Roli i OJQ-ve**

Në Shqipëri, OJQ-të të cilat punojnë në promovimin dhe mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut janë mjaft aktive. Qendra Shqipëtare për të Drejtat e Njeriut (QSHDNJ) udhëheq projekte që ofrojnë trajnime për të drejtat e njeriut për policë, praktikoner të ligjit, gazetarë, etj. OJQ-të e tjera të cilat ofrojnë trajnime në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore përfshijnë Qendrën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri (CRCA) dhe Klinika ligjore për të miturit (këto OJQ gjithashtu ofrojnë ndihmë falas për fëmijë). AHC dhe CRCA ofrojnë „ SOS linja” apo qendra të ankesave ku viktimat mund të sjellin ankesat të cilat mund, nëse janë të përshtatshme, të sillen në vëmendje të autoriteteve dhe të publikohen; këshillat ligjore janë gjithashtu në dispozicion. Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka një program për monitorimin e burgjeve, stacioneve të policisë dhe qendrave të paraburgimit, ndërsa OJQ-të e tjera gjithashtu kanë monitoruar këto institucione.

Qendra Shqipëtare e Rehabilitimit të Torturës ofron trajtime të specializuara mjekësore dhe psikiatrike, mbështetje sociale dhe ligjore për viktimat e torturës, si dhe organizon trajnime për profesionistët (edukatorët e të drejtave të njeriut, personelët mjekësor, personelët e burgjeve, etj). Në aktivitetet e saj aktuale, QSHRT ofron trajtim të specializuar mjekësor dhe psikologjik, si dhe ndihmën ligjore ndaj viktimave të torturës dhe të afërmit e tyre; organizon fushata për ngritjen e vetëdijes, tryeza të rrumbullakëta, grupet e reflektive, trajnime dhe aktivitete të tjera, për të parandaluar mundësinë e formave të maskuar të torturës; kryen studime kërkimore për të përcaktuar karakteristikat e sfondit kulturor të Shqipërisë në lidhje me konceptin e formave të ndryshme të torturës; dhe shpërndan materiale të ndryshme që lidhen me rastet e traumave, torturave, shëndetit mendor dhe të drejtat e njeriut. QSHRT ka Memorandume dhe lejet për të kryer monitorimin në vendet e privimit të lirisë: policinë (nga viti 2010 e tutje), paraburgimet dhe burgjet (që nga viti 2009 e tutje).

### 2.3.5. Organizatat ndërkombëtare

Organizatat ndërkombëtare vazhdimisht rekomendojnë që Shqipëria duhet të ndërmarrë hapa të shpejtë të përmirësimit të rolit të kontrollit mbi institucionet e drejtësisë, policisë, dhe institucionet e shëndetit, në mënyrë që t'i shtyj ato që të venë në praktikë vendimet dhe të ndajnë përgjegjësitë.

Amnesty International (AI) ka shprehur shqetësim të madhë në raportin e vet vjetorë të vitit 2015 *që keqtrajtimet e të dyshuarve në stacionet e policisë kanë qenë të përhapura; policia dhe personeli mjekësor ka dështuar në detyrën e tyre për të raportuar incidente të tilla. Në korrik, Avokati i Popullit njoftoi mbi mbipopullimin kronik dhe kushte dhe kujdes shëndetësor joadekvatë në hapsirat e paraburgimit.*<sup>8</sup>

Raporti i KE-së (2015) thekson se: „Për parandalimin e torturës dhe keqtrajtimet, në vitin 2014 Mekanizmi Kombëtarë për Parandalimin e Torturës (MKPT), ka realizuar 115 inspekte, kontrolle dhe vizita monitoruese. Të 81 rekomandimet që kanë rezultuar janë pranuar, por shumica e tyre nuk janë adresuar. Në vitin 2014, MKPT-ja dhe Zyra e Avokatit të Popullit ka trajtuar 35 ankesa për përdorimin disproporcional të forcës dhe dhunës nga ana e oficerëve të policisë dhe rojeve të burgjeve, tetë nga të cilat janë gjetur të kenë arsye të vlefshme. Shumë pak hetime janë nisur ndaj punonjësve të policisë. Në disa burgje, janë vendosur njësitë e kujdesit të veçantë që ofrojnë mbështetje psikologjike. Asnjë progres nuk është bërë për ngritjen e një instituti të specializuar mjekësor për të trajtuar të ndaluarit të sëmurë mendorë, të cilët vazhdojnë të mbahen në kushte të papërshtatshme në paraburgim në spitalin e burgut të Krujës. Veprimi mëtejshëm është i nevojshëm për të siguruar trajtim të specializuar për këtë kategori të rrezikuar të të burgosurve në të gjitha objektet. Mbiipopullimi i sistemit të burgjeve mbetet një shqetësim.

Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës e të Dënimeve ose të Trajtimeve Çnjerëzore dhe Degraduese (KPT) u krijua nën Konventën e Këshillit të Evropës të vitit 1987 me të njëjtin emër (e quajtur më tej „Konventa”). Sipas nenit 1 të Konventës: „Të formohet një

<sup>8</sup> <https://www.amnesty.org/en/documents/pol10/2552/2016/en/>



Komitet evropian për parandalimin e Torturës dhe Dënimeve ose Trajtimeve të tjera Çnjerëzore ose Degraduese ... Komiteti, me anë të vizitave, të shqyrtojë trajtimin e personave të privuar nga liria me qëllim që të përforcojë, në rast se është e nevojshme, mbrojtjen e tyre kundër torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese. „ Puna e KPT-së është projektuar të jetë një pjesë integrale e sistemit të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke vendosur një mekanizëm aktiv jo-gjyqësor së bashku me mekanizmin ekzistues reaktivë gjyqësor të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në janar të vitit 2014, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor ose Degradues (KPT) ka kryer vizitën periodike në Shqipëri.<sup>9</sup>

Lidhur me kushtet materiale të paraburgimit në qendrat policore, KPT-ja ka shënuar pak progres. Në veçanti, të gjitha qelitë e ndaljes në institucionet e vizituara (të parashikuara për një qëndrim deri në dhjetë orë) ishin të pajisur me mjetet për pushim (një karrige ose një stol). Më tej, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë dhe Stacionit policor Korçë, kushtet e përgjithshme të paraburgimit ishin ngritur në një nivel të pranueshëm. Megjithatë, kushtet e paraburgimit mbetën jashtëzakonisht të varfër në të gjitha qendrat e tjera të vizituara (dmth. stacionet e policisë në Elbasan, Pogradec, Sarandë, Vlorë dhe stacionet e Policisë Tiranë Nr. 1 dhe 2). Shumica e qelive të arrestimit në këto institucione janë gjetur të jenë në një gjendje të mjerueshme sa i përket mirëmbajtjes dhe higjienës dhe kishin qasje të kufizuara të dritës natyrore. Për më tepër, ndriçim artificial ishte shpesh i dobët ose nuk ekzistonte, ventilimi ishte i papërshtatshëm dhe sistemi i ngrohjes nuk funksiononte. Në mënyrë të veçantë, në Komisaratin e Policisë nr.1 Tiranë, personat e ndaluar nganjëherë mbaheshin në kushte me hapsirë shumë të vogël (p.sh. katër persona në një qeli të 5m<sup>2</sup>).

KPT-ja u bën thirrje autoriteteve Shqipëtare të ndërmarrin masa urgjente që të përmirësojnë mungesat e lartpërmendura.

Në asnjë nga qendrat e vizituara nuk pati ankesa për keqtrajtime të fundit të të burgosurve nga personeli i kujdestarisë dhe, në përgjithësi, marrëdhëniet midis stafit dhe të burgosurit duket të jenë pa tension. Për më tepër, delegacioni nuk gjeti asnjë shenjë që do të sugjeronte se dhuna në mes të burgosurve ishte një problem i madh në institucionet e vizituara. Megjithatë, në burgun e Peqinit, delegacioni dëgjoi një numër të pohimeve për keqtrajtim fizik të të burgosurve nga anëtarët e njësisë së ndërhyrjes speciale të administrates së burgjeve qendrore në kuadër të kërkimeve të qelive.

## **2.4. Përgjigje – Rastet e torturës**

Tortura penalizohet sipas nenit 86 të Kodit Penal. Sipas raporteve vjetore dhe analizave të veprimtarisë së Prokurorit Publik Shqiptar, numri i ankesave që rezultuan me hetime sillen nga 2 në vitin 2012 deri në 1 në vitin 2013, 2 në vitin 2014, dhe 2 në vitin 2015, por asnjë nga këto raste nuk kanë një vendim përfundimtar të gjykatës si tortura. Të dhënat tregojnë<sup>10</sup>, megjithatë, se policia e Shtetit Shqipëtarë ka më shumë se 230 policë me masa disiplinore, duke përfshirë edhe ata që janë „dënuar” nga gjykatat në bazë të nenit 250 të Kodit Penal.

9 <http://www.cpt.coe.int/documents/alb/2016-06-inf-eng.pdf>

10 Të dhënat zyrtare të cilat i shpalli Republika e Shqipërisë në shkurt të vitit 2016

Mbështetja ligjore për viktimat e torturës ose trajtimit çnjerëzor dhe degradues është dhënë nga QSHRT në rastet e mëposhtme gjyqësore penale në lidhje me torturën dhe keqtrajtimin, ku hetimet e duhura në përputhje me standardet ndërkombëtare nuk janë kryer nga autoritetet.

### **Rasti i P.S. (torturë)**

Ky rast është dokumentuar nga QSHRT dhe MKPT e Avokatit të Popullit më 31 dhjetor të viti 2009. Intervista është marrë nga ora 13.45 deri në 14.15, në Drejtorinë e Policisë së Përgjithshme Tiranë në praninë e P.S, i lindur në vitin 1982, nga Tirana, Rruga Kongresi i Lushnjës. Ai raportoi pasoja të rënda fizike dhe psikologjike si rezultat i nënshtrimit të dhunës policore nga ana e Komisarariatit nr. 2.

P.S. është ndihmuar nga ekspertët pasi që ai nuk mund të lëvizëste krahët për shkak të dhimbjes. P.S. kishte kontuzione, çarje dhe dëmtime të shaktuara nga rrahja në duar, fytyrë dhe trup. Grupi monitorues ka dokumentuar rastin dhe ka hartuar rekomandime për hapat e mëtejshme që duhet të ndërmerren.

### **Rasti i S.M. (torturë)**

Ligji për Mbrojtësin e të Drejtave të Njeriut gjithashtu parashikon një mekanizëm të shqyrtimit të ankesave ndaj Avokatit të Popullit (nenet 28-35). Ankesa mund të bëhet brenda një viti pasi që shkëlja e pretenduar ka ndodhur. Në raste të veçanta, Avokati i Popullit gjithashtu mund të marrë në konsideratë ankesën pas afatit prej një viti. Gjatë hetimit të ankesës, Avokati i Popullit do të duhet ti shfrytëzoj të gjitha mjetet në dispozicion në vend, të vëzhgoj burime të tjera informacioni, të hetojë zyrtarët publikë, etj. Kur Mbrojtësi konstaton se shkëlja e të drejtave dhe lirive të njeriut ka ndodhur, mendimi i tij/saj duhet të përmbajë një rekomandim mbi atë që duhet të bëhet për të korrigjuar shkeljen, si dhe afatin për përmirësim.

Ligji gjithashtu parashikon edhe raportet vjetore publike të Avokatit të Popullit. Mbrojtësi mund të paraqesë një raport të veçantë në Parlament, nëse ai/ajo e sheh të nevojshme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Raportet e veçanta gjithashtu duhet mundësuar të jenë në dispozicion të publikut.

#### **3.3.2. Mekanizmi Kombëtar Parandalues**

MKPT-ja në Mal të Zi është një sistem klasikë i Ombudsman Plus që përdoret mbarë në Evropë dhe botë. Sistemi Avokati i Popullit Plus ka qenë mjaft i dobët në kontekst ku situata e përgjithshme e të drejtave të njeriut dhe pavarësia e gjyqësorit është e diskutueshme. Megjithatë, në të gjitha ato kontekste ku të drejtat e njeriut respektohen në mënyrë të favorshme, ky sistem ka treguar që funksionon mirë dhe jep rezultate të mira.

Mali i Zi ka ratifikuar Protokollin Opsional të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës (OPCAT), në mars të vitit 2009 dhe ka themeluar Mekanizmin Kombëtarë Parandalues (MKPT) në shtator të vitit 2011, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Avokatin e Popullit. Pas formimit të Trupit këshillëdhënës të ekspertëve (të përcaktuar sipas ligjit të sipërpërmendur si trup që ndihmon Avokatin e Popullit në kryerjen e aktiviteteve si MKPT), zëvendës Avokati i Popullit është emëruar në mënyrë specifike për parandalimin e torturës, derisa dhe dy këshilltarë ligjorë brenda zyra e Avokatit të Popullit janë caktuar vetëm për detyrat dhe aktivitetet lidhur me MKPT.

MKPT ka zhvilluar tashmë vizita të shumta në vendet e privimit të lirisë të cilat kanë rezultuar me publikimin e dy raporteve tematike mbi institucionet policore psikiatrike. Stafi i MKPT nga zyra e Avokatit të Popullit, si dhe anëtarët e Trupit këshillëdhënës, po kryenin një vlerësim të Burgut ekzekutiv në kohën e vizitës së KPT-së.

Neni 25 i Ligjit mbi Mbrojtësin e të Drejtave të Njeriut deklaroi se Mbrojtësi do të jetë Mekanizëm Kombëtarë Parandalues për mbrojtjen e personave të privuar nga liria, nga tortura dhe trajtimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruës, ose dënimi (në tekstin e mëtejshëm referuar si: parandalimi i torturës), në përputhje me Protokollin Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës. Për të kryer detyra të caktuara për parandalimin e torturës që kërkojnë një njohuri të specializuar, Mbrojtësi do të formojë një trup pune të përbërë nga ekspertë të fushave përkatëse. Akti për krijimin e organit këshillimor, i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, do të përcaktojë detyrat dhe mënyrat e funksionimit të këtij organi.

Sipas Nenit 25a, anëtarët e trupit të referuar në paragrafin 2 të nenit 25 të këtij ligji, emërohen nga Mbrojtësi bazuar në thirrjen publike. Numri, përbërja, kriteret, dhe mënyra e emërimit të anëtarëve të organit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni përcaktohen në Rregulloren e Punës së Mbrojtësit. Sipas Nenit 25b, parandalimi i torturës përfshin:

- Vizita e autoriteteve, institucioneve ose organizatave në të cilat mund të gjinden personat e privuar nga liria dhe personat me lëvizje të kufizuar, me qëllim të rritjes së nivelit të mbrojtjes së tyre nga tortura dhe trajtimi mizor, çnjerëzor dhe poshtëruës, ose dënimi;
- Dhënia e rekomandimeve për autoritetet kompetente, institucionet dhe organizatat për të përmirësuar trajtimin e personave të privuar nga liria dhe kushtet në të cilat ata qëndrojnë, apo parandalimin e torturës dhe trajtimin të egër, çnjerëzor dhe poshtëruës ose dënimi;
- Dhënia e mendimeve për ligjet dhe rregulloret për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të personave të privuar nga liria dhe personave me një lëvizje të kufizuar;
- Bashkëpunimi me Nënkomitetin e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës (në tekstin e mëtejshëm Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës).

Personat e privuar nga liria, siç përshkruhet nga dispozitat e këtij ligji, janë personat të cilëve u është caktuar çdo lloj mbajtjeje, paraburgimi, burgimi ose vendosje nën mbikëqyrjen e autoritetit, dhe të cilët këtë vend nuk mund ta braktisin me vullnetin e tyre.

KPT-ja ka regjistruar faktin se funksionet e MKPT-ës i kryejn njësitë e veçanta në kuadër të zyrës së Avokatit të Popullit, i cili ka stafin e vet të dedikuar. Në lidhje me paragrafin 32 të Udhëzuesve për Mekanizmin Kombëtar Preventiv, të miratuara nga Nënkomiteti i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor dhe Poshtëruës (SPT), Komiteti rekomandon që të merret në konsideratë krijimi i një linije të veçantë buxhetore për aktivitetet e MKPT në kuadër të buxhetit të përgjithshëm të Zyrës së Avokatit të Popullit. KPT-ja gjithashtu do të donte të informohet për mjetet buxhetore të dedikuara për aktivitete të MKPT-së në vitin 2013 dhe 2014.”<sup>19</sup>

---

19 <http://www.cpt.coe.int/documents/mne/2014-16-inf-eng.pdf> fq. 9

Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Shërbimit Profesional ka përcaktuar organizimin e MKPT-së, i cili kryesohet nga Zëvendës Mbrojtësi i të Drejtave të Njeriut me ndihmën e pesë Këshilltarëve. Sipas kompetencave të përcaktuara me Ligjin e përmendur, Mbrojtësi lëshon një thirrje publike për zgjedhjen e anëtarëve të MKPT. Anëtarët e MKPT i zgjedh Mbrojtësi dhe përbëhet nga profesionistë në fushën e psikiatrisë dhe psikologjisë, si dhe avokatë dhe mjekë ligjorë. Procedura e zgjedhjes dhe emërimit është e përshkruar në nenet 15, 16, 17, 18 dhe 19. Akti mbi themelimin e MKPT-së përcakton detyrat dhe kompetencat e saja.

Me qëllim të përmirësimit të rolit si MKPT, Mbrojtësi përcakton planin vjetor të vizitave të organizatave dhe institucioneve ku gjenden personat e privuar nga liria, e bazuar në planin katërvjeçarë të miratur më pare.

» *Mangësitë*

Duhet të sigurohet financimi shtesë dhe adekvat i MKPT.

Ligji specifik mbi MKPT nuk ekziston në Mal të Zi, sepse Mbrojtësi është njëkohësisht edhe MKPT, ashtu që kompetencat e Mbrojtësit si MKPT janë të përshkruara në kuadër të Ligjit mbi Mbrojtësin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

### **3.3.3. Mekanizmat e tjerë monitorues**

- Në pajtim me Ligjin për Punë të Brendshme, kontrollimi i policisë bëhet nga kontrolli i brendshëm dhe Këshilli për Kontrollin Civil të Policisë.<sup>20</sup>
  - Prokurori gjithashtu mund të bëj hetime në objektet policore dhe burgjet në pajtim me Kodin e Procedurës Penale.
  - Avokati i Popullit ka leje të hyjë në të gjitha vendet ku gjenden personat e privuar nga liria (shih Ligjin mbi Mbrojtësin Neni 25b).
  - Gjykata e Lartë ka juridiksion për të kontrolluar hetimin e burgjeve sipas Kodit Penal dhe të Procedurës Penale.
- Më poshtë gjenden emrat e të gjithë OJQ-ve si grup monitorues për të gjitha institucionet e ndryshme të përmendura- grupet e OJQ-ve:

*1. Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, partnerët lokal: Aleanca qytetare, NVO 4life, LGBT Forum Progress*

*2. OJQ Human Rights Action, Juventas<sup>21</sup>*

---

20 Policia dhe të drejtat e njeriut: kontrolli i punës së policisë në praksë nga ana e qytetarëve, [http://www.kontrolapolicije.me/index.php?option=com\\_content&view=article&id=5&Itemid=107&lang=sr](http://www.kontrolapolicije.me/index.php?option=com_content&view=article&id=5&Itemid=107&lang=sr) fq: 6-7

21 <http://www.hraction.org/?p=6945>



### 3.4. Përgjegje – Rastet e torturës

Në shumë raste, ekzaminimet e rasteve të torturës tregojnë se tortura nga zyrtarët e zbatimit të ligjit bëhet për qëllim të sigurimi të informacionit në lidhje me krimin, zgjidhjen e krimit apo dënimin për mos bindje. Në një numër të rasteve të torturës janë përshkruar<sup>22</sup> rrethana të ngjashme dhe qasje të ngjashme nga hetimi. Rastet e torturës ndodhin mbrenda institucioneve të mbyllura, gjatë kapjes dhe gjatë tubimeve dhe demonstrimit, për çfarë do të bëhet fjalë në këtë raport.

### 3.5. Vendet e privimit të lirisë

*Ministria e Drejtësisë*

ZIKS

Institucioni për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (ZIKS) është përgjegjës që të paraburgosurve dhe personave të akuzuar t'u ofrojë sigurinë, mbrojtjen shëndetësore, trajtimet, dhe ri-integrimin e të burgosurve, si dhe trajnimin profesional të stafit të këtij institucioni dhe detyra të tjera të rëndësishme për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Struktura e Institucionit është e definuar në bazë të gjashtë njësisive organizative:

- Qendra e paraburgimit dhe rehabilitimi në Podgoricë (KPD Podgorica)
- Paraburgimi në Podgoricë
- Burgu për dënime afatshkurtra
- Burgu Bijelo Polje
- Shërbimi i kujdesit shëndetësor
- Qendra për arsimimin e stafit.

Varësisht nga niveli i sigurisë, lloji i trajtimit dhe programit ri-integrues, si dhe sferën e kufizimeve të lirisë dhe të drejtave të personit të akuzuar, dënimet me burgim ekzekutohen në ambiente të llojeve të mbyllura, gjysëm të hapura dhe të hapura, edhe pse lloji i hapur nuk ka filluar të funksionoj akoma.

Kapaciteti aktual në ZIKS janë 1350 vende. Nga ky numër: KPD Podgoricë – 655, Paraburgim Podgoricë – 350, Burgu për dënime afatshkurtra – 185, and Burgu në Bijello Pole – 160 vende.

*Ministria e Punëve të brendëshme:*

– Qendrat dhe departamentet e sigurisë në Podgoricë, Tivar, Budve, Berane, Bijello Pole, Nikshiq, Plevla, Herceg Novi, Andrijevicë, Danilovgrad, Ulqin, Kotorr, Tivat, Plav, Pluzhinë, Rozhajë, Zhablak, Kolashin, Mojkovac, Shavnik, dhe Cetinjë; kalimet kufitare ujore në portin e Tivarit, Kotorrit, Tivatit-Porto Montenegro, dhe Zelenikë; kalimet kufitare ajrore në aeroportet në Podgoricë dhe Tivat; kalimet kufitare tokësore dhe Strehimore për të huajt

22 <http://www.gamn.org/images/docs/en/HumanRightsInMontenegro.pdf> fq. 40- 52

në Spuzh. Administrata e policisë nuk është përgjigjur kërkesës tonë për informatat mbi numrin e saktë të vendeve të paraburgimit. Sipas informatave tona, Policia ka së paku 35 hapsira për privim të lirisë.

*Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale:*

Qendra për kërkuesit e azilit në Spuzh dhe dy vende shtesë për kërkuesit e azilit në Podgoricë, Insitucioni publik „Komanski most,, në Podgoricë, Qenda për Fëmij dhe të Rinj „Luboviq,, Podgoricë, Insitucioni i fëmijve „Mladost,, në Bijella, shtëpia për të moshuar në Bijello Pole dhe Risan.

*Ministria e Shëndetësisë:*

Spitali special – Dobrota, Departamentet psikiatrike në Nikshiq dhe Podgoricë.

### **3.6. Fushat e shqetësimit**

#### **Institucionet kryesore ku tortura ndodhë me shpesh**

Në Malë të Zi, tortura nuk është e përhapur si më pare. Para disa viteve tortura ndodhte më shpesh në këto institucione:

1. ZIKS (Insituti për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale)- burgu i Malit të Zi
2. Insituti „Komanski Most”- institucion publikë i cili ofron strehim për persona me aftësi të kufizuara mendore.

#### **Institucionet që janë të mbipopulluara përtej kapaciteteve**

Kapaciteti (K)/Numri aktual i të burgosurve (B)

KPD Podgoricë – K655/ B665

#### **Spitali Special Psikiatrik**

Departamenti gjyqësor ka kapacitet për 20 pacientë. Të gjithë kapacitetet janë të mbushura, plus në këtë spital ndodhen edhe 50 pacientë të tjerë me masat e imponuara gjyqësore të trajtimit. Megjithatë, të gjithë janë të vendosur në departamentet e tjerë. Kapaciteti total i spitalit është 240 pacientë, megjithatë numri total i pacientëve është shumë më i madhë.

#### **Veprimet e policisë gjatë mitingjeve dhe demonstratave dhe arrestimi në fazën preliminare**

YIHR ka regjistruar 25 ankesa të qytetarëve gjatë protestave në tetor të vitit 2015. Në 9 raste, Këshilli për kontrollin e punës së Policisë ka gjetur një numër të tepërt të punonjësve të policisë dhe shkelje të të drejtave të qytetarëve. Raste të tjera janë në zhvillim e sipër pranë Zyrës së Prokurorit të Shtetit. Gjatë protestave, qytetarët ishin të ekspozuar ndaj torturës dhe përdorimit të tepruar të forcës nga policia. Dëshmia për këtë është paraqitur

në raportin e AQ-së (Aleanca Qytetare) së bashku me dokumentacionin dhe dëshmitë e plota. Institucionet përkatëse nuk janë përgjigjur në mënyrë profesionale ankesave të qytetarëve, organizatave joqeveritare, dhe publikut të gjerë në lidhje me trajtimin e qytetarëve gjatë protestës. Vetëm dy policë janë identifikuar dhe janë mbajtur përgjegjës për aktet e dhunshme gjatë asaj nate.

### **Aksesi në kujdesin shëndetësor nga njerëz të privuar nga liria**

Personat e privuar nga liria kanë të drejtë në kujdes shëndetësor në burgje dhe në polici. Megjithatë, numri më i madh i ankesave që kanë marrë OJQ-të i referohen ankesave ndaj kualitetit të kujdesit shëndetësor. Shpesh kapacitetet nuk shfrytëzohen tërësisht dhe më pak mjek punojnë se sa është e parashikuar me reformë. KPT ka bërë të ditur këtë dhe ka rekomanduar që të rritet numri i punonjësve mjekësor.

Shumë shpesh të dënuarit duhet të presin për trajtim bazë për disa muaj meqë ajo shpesh nuk është në dispozicion në burgje.

Avokati i Popullit ka zbuluar një rast ku personi i cili ishte HIV pozitiv ka qenë në izolim për 20 ditë, pa akses në kujdes shëndetësor apo ilaçe.

### **Shqetësimet kryesore nga raportet e SPT OKB-së dhe KPT Këshillit të**

#### **Tortura dhe format e tjera të keqtrajtimit**

„14. Siç ishte rasti gjatë vizitave të mëparshme, delegacioni i cili ka kryer vizitën në vitin 2013 në Mal të Zi ka marrë shumë akuza të keqtrajtimit të qëllimshme fizike të personave të privuar nga liria nga ana e policisë. Pjesa më e madhe e akuzave të përmendura i referohej keqtrajtimit të shkaktuar në momentin e marrjes në pyetje me qëllim që të nxjerrin një rrëfim apo të marrin ndonjë informacion. Keqtrajtimi i dyshuar në disa raste ka qenë i një shkalle të tillë që mund të konsiderohet torturë.” (Raporti i KPT-së nga viti 2013)

#### **Kushtet e paraburgimit**

„34. Kushtet e ndalimit në qelitë policore të vizituara nga delegacioni i KPT-së ishin në gjendje shumë më të mire sesa gjatë vizitës në vitin 2008. Në veçanti, renovimet në Stacionin e policisë në Tivar dhe Danillovgrad përmirësuan mungesat që KPT ka theksuar në Raportin e tij gjatë vizitës; qelitë tani kanë hapsirë për pushim me dyshekë dhe batanije, sistem ventilimi i cili punon dhe zile për thirjen e stafit. Megjithatë, shumë mungesa janë akoma të pranishme. Në stacionin policor në Kotorr, qelia e parashikuar për vendosje të dy të paraburgosurve ka madhësi vetëm 6m<sup>2</sup> dhe nuk ka akses në dritë natyrore; në stacionin policor në Herceg Novi, në qelitë është ftohtë dhe nuk depërton drita natyrore, derisa ndriçimi artificial është shumë i dobët; në Stacionin e policisë në Ulqin, në asnjë qeli nuk punon ndriçimi, aksesin ndaj dritës natyrore është minimale dhe ventilacioni është shumë i dobët në qelitë e bodrumit. Për më tepër, në asnjë institucion të policisë që kemi vizituar të akuzuarve nuk u është ofruar qëndrimi jashtë. KPT i merr në konsiderim të gjitha masat që qeveria e Malit të Zi ka ndërmarrë që të përmirësohen kushtet e paraburgimit në Stacionet e policisë pas vizitës së vitit 2008. Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapat që do të përmirësojnë mungesat në Stacionet e përmendura të policisë; sa i përket qelisë në Stacionin e policisë në Kotorr me përmasa 6m<sup>2</sup>, ajo duhet të shfrytëzohet për një person

vetëm. Krahas kësaj, Komiteti rekomandon që qeveria e Malit të Zit të ndërmarr masa që të gjithë personave që gjinden në paraburgim në stacionet e policisë për 24 ore e më shumë, t'u mundësohet rekreacioni jashtë. „(KPT reporti për vitin 2013)

### **3.7. Rekomandimet**

- Autoritetet gjyqësor duhet të mundësojnë numër të konsiderueshëm të trajnimeve për gjyqtarët dhe prokurorët, veçanërisht në fushën e shkeljeve të të drejtave siç është keqtrajtimi dhe tortura. Kjo në veçanti për arsye se deri tani autoritetet nuk u kanë mundësuar viktimave të luftës të drejtën për të vërtetën, drejtësi, kompenzim dhe mos-përsëritje të krimeve të luftës gjatë viteve të '90-ta.
- Zyra e Prokurorit të shtetit duhet të përfshijë Protokollin e Stamollit në programin e trajnimit për Prokurorët.
- Prokuroritë e Shtetit duhet të zbatojnë hetime urgjente të pavarura dhe efektive në të gjitha akuzat e keqtrajtimit dhe torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose dënimit. Zyrtarët duhet të ndiqen penalisht njësoj si qytetarët.
- Shteti duhet të sigurojë Institucionin e Avokatit të Popullit me burime të mjaftueshme (buxhet dhe hapësirë) për të kryer rolin në përputhje me kompetencat e sajë, MKPT në veçanti.
- Qeveria duhet të sigurojë një numër të mjaftueshëm të punonjësve në të gjitha institucionet që përdoren për të akomoduar personat e privuar nga liria. Kryesisht, është e nevojshme për të punësuar një staf të madh profesional dhe mjekësor.
- Është e nevojshme të sigurohet respektimi i të drejtave themelore të njeriut gjatë paraburgimit. Autoritetet e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administrata e Policisë duhet rregullisht të 'dërgojnë mesazhe' se keqtrajtimi dhe trajtimi çnjerëzor i qytetarëve nga ana e zyrtarëve nuk do të tolerohet. Administrata e Policisë duhet të bashkëpunojë me të gjitha institucionet shtetërore dhe organet e tilla si Zyra Themelore e Prokurorisë së Shtetit dhe Këshilli për Kontrollin Civil të Punës së Policisë, dhe të komunikoj rregullisht emrat e punonjësve të policisë të cilët kanë vepruar në mënyrë të paligjshme dhe kanë shkelur të drejtat e njeriut.
- Administrata e Policisë duhet t'i shmanget praktikës së kthimit të policëve të dënuar për torture në vende të punës që përfshijnë komunikimin e drejtpërdrejtë dhe punën me qytetarët e privuar nga liria.
- Administrata e Policisë duhet të ofrojë monitorimin video dhe të kryej përshtatjen e të gjitha vendeve të ndalimit për personat e privuar nga liria.
- Administrata e Policisë duhet të vazhdojë me trajnime për përdorimin e mjeteve shtrënguese. Të gjithë zyrtarët duhet t'i kalojnë këto trajnime.
- Është e rëndësishme që të i kushtohet më shumë vëmendje edukimit të punëtorëve mjekësor rreth raportimit të rasteve të torturës, sepse praktika e mëparshme tregon se lëndimet nuk janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme ose gjetjet/analiza nuk ishin mjaft të qarta.

- Është e nevojshme që të reduktohet mbipopullimi në burgje dhe vende të tjera, ku qytetarët janë të privuar nga liria. Gjykatat duhet më shumë të imponojnë sanksione alternative, dhe gjyqtarët dhe prokurorët duhet të kenë më shumë trajnime në këtë fushë me qëllim të inicimit të vendime që janë të drejtuar kah shërbimi i sanksioneve alternative.
- Ministria e Drejtësisë duhet të vazhdojë me programet që nxisin sanksione alternative. Është e nevojshme që të zgjerohet rrethi i institucioneve, ku mund të realizohet puna me interes publik. Prandaj, është e nevojshme për të lëvizur në drejtim të ndryshimit të zgjidhjes legislative, si dhe zgjerimin e punës për interes publik përtej entiteteve juridikë që marrin pjesë në aktivitete me interes publik (humanitare, sociale, komunale, shëndetësore, bujqësore) drejt organizatave jo-qeveritare, pasi ato janë jo-fitimprurëse nga natyra.
- Si prioritet, Qeveria duhet të gjejë një zgjidhje për problemin e mbipopullimit në Spitalin Special Psikiatrik në qytetin e Kotorrit. Është e nevojshme që shteti të zhvilloj sistemin e kujdesit social, si dhe të rris mundësinë e alternativave të përshtatshme në spitalet psikiatrike. Gjithashtu, është e nevojshme të sigurohet që personat, të cilët nuk kërkojnë trajtim të mëtejshëm në Spitalin special për psikiatri, të fitojnë mbrojtjen e duhur. Ju rikujtojmë që Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore ka bërë të njëjtat rekomandime për Mal të Zi në vitin 2014. Në situatën e tillë do të rritej numri i pacientëve që do të marrin pjesë në aktivitetet terapeutike dhe rehabilituese të cilat janë të përshtatura nevojave të tyre, dhe do të ishte e mundur të zgjerohej përhapja e aktiviteteve të tilla.
- Institucionet shtetërore duhet të inkurajojnë dhe të iniciojnë përfshirjen e OJQ-ve në monitorimin e vendeve të ndalimit të personave të privuar nga liria.
- OJQ-të duhet të vazhdojnë të kryejn një monitorim të rregullt të vendeve të ndalimit të personave të privuar nga liria dhe të informojnë institucionet dhe publikun mbi gjetjet. OJQ-të duhet të bashkëpunojnë me institucionet shtetërore dhe të organizojnë programe edukative për nëpunësit shtetëror.



## IV SERBIA

### 4.1. Informata të përgjithshme mbi vendin

Serbia është republikë parlamentare kushtetuese. Pushteti ekzekutiv ushtrohet nga Qeveria në krye me Kryeministrin. Kryeministri është zgjedhur nga Kuvendi Kombëtarë me propozim të Presidentit, i cili e emron atë pas konsultimeve me të gjithë liderët parlamentarë.

Presidenti zgjidhet në bazë të votave të popullit, por ai ka një juridiksion të vogël dhe në radhë të parë ka një pozitë ceremoniale. Mandati i Presidentit zgjatë pesë vjetë, dhe mund të zgjidhet për dy mandate më së shumti. Anëtarët e Qeverisë emërohen nga Kryeministri dhe konfirmohen nga Kuvendi Kombëtarë. Fuqia e Qeverisë i takon Kryeministrit, Zëvendës Kryeministrit dhe ministrave të tjerë. Kryeministri është përgjegjës për paraqitjen e agjendës së vet para Kuvendit Kombëtarë, si dhe propozon ministrat për postet e kabinetit në Qeverinë e tij. Qeveria konsiderohet e zgjedhur në qoftë se ajo ka fituar shumicën e votave të të gjithë përfaqësuesve në Kuvendin Kombëtarë.

Serbia ka 7.186.862 banorë.

Në bazë të regjistrimit të fundit (nga viti 2011), 83% e popullsisë janë serbë, ndërsa të kombësive të tjera janë hungarezët (3.5%), romët (2%), boshnjakët (2%) dhe 9% e të gjithë të tjerëve (me përjashtim të Kosovës).

Kryeqyteti i Serbisë është Beogradi, i cili është edhe qyteti më i madh me popullsi prej 1,659.440 (popullata e zonës së gjërë). Qytete të tjera të mëdha janë Novi Sad (341.625), Nish (260.237), Kragujevac (179.417), Subotica (141.554), Pançevo (123.414), Zrenjanin (123.362), Çaçak (115.337), Kralevo (125.488), Novi Pazar (100.140) Leskovac (144.206), Smederevo (108.209), Vranje (83.524), Uzhicë (78.040), Valevo (90.312), Krushevac (128.752), Shabac (115.884), Pozharevac (75.334), Sombor (85.903), Zajeçar (59.461), Sremska Mitrovica (79.940), Jagodina (71.852), dhe Loznica (79.327).

Serbia ka vendosur marrëdhënie diplomatike me të gjitha vendet fqinje (Hungarinë, Rumaninë, Bullgarinë, Maqedoninë, Malin e Zi, Kroacinë dhe Bosnjën e Hercegovinën). Me Kosovën (e cila shpalli pavarësinë në vitin 2008), situata është disi e veçantë – Serbia në Prishtinë nuk ka përfaqësi diplomatike, por oficer ndërlidhës. Gjithashtu, me ndihmën e Bashkimit Evropian, Serbia dhe Kosova janë duke udhëhequr negociatat në Bruksel, me qëllim të normalizimit të marrëdhënieve ndërshtetërore.

Slobodan Millosheviqi erdhi në pushtet në vitin 1989. Millosheviq ka premtuar se do të reduktoj fuqinë e dy krahinave autonome të Serbis-Kosovës dhe Vojvodinës-ku aleatët e tij pastaj morën qeverinë gjatë Revolucionit anti-burokratik. Kjo ka ndezur tensionet me udhëheqësit komunistë të republikave të tjera, ka zgjuar edhe nacionalizmin në të gjithë Jugosllavinë, e cila përfundimisht rezultoi me shpërbërjen e saj. Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia shpallën pavarësinë, ndërsa Serbia dhe Mali i Zi mbetën së bashku si Republikë Federale e Jugosllavisë (RFJ).

Nxitur nga tensionet etnike, luftërat në Jugosllavi shpërthyen në vitin 1991. Konfliktet më të rënda ndodhën në Kroaci dhe Bosnje, ku popullata etnike serbe kundërshtoi pavarësinë nga Jugosllavia. RFJ ka mbetur jashtë konfliktit, por ka dhënë mbështetje logjistike, ushtarake dhe financiare për forcat serbe në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë. Për këtë arsye, OKB-ja vendosi sanksione kundër Republikës Federale të Jugosllavisë në maj të vitit 1992, gjë që

çoi në një izolim politik dhe rënie të ekonomisë. Demokracia shumëpartiake u prezantua në Serbi në vitin 1990, me ç'rast zyrtarisht u shpartallua sistemi njëpartiak.

Kritikët e Millosheviqit pohonin se qeveria ka vazhduar të jetë autoritare, pavarësisht nga ndryshimet kushtetuese, sepse Millosheviqi ka mbajtur një ndikim të fortë politik mbi median shtetërore dhe aparatin e sigurisë. Kur Partia Socialiste e Serbisë refuzoi të pranojë humbjen në zgjedhjet komunale të vitit 1996, qytetarët u angazhuan në protesta të mëdha kundër Qeverisë. Në fund të vitit 1998 dhe fillim të vitit 1999, paqja është thyer përsëri, kur situata në Kosovë është përkeqësuar nga përlëshjet e vazhdueshme midis forcave jugosllave të sigurisë dhe guerilëve shqiptarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Konfrontimet çuan deri në Luftën e Kosovës, e cila përfundoi me tërheqjen e forcave serbe nga Kosova dhe vendosjen e administratës së OKB-së në këtë krahinë.

Pas zgjedhjeve presidenciale në shtatorë të vitit 2000, partitë e opozitës akuzuan Millosheviqin për një mashtrim elektoral. Si pasojë u organizua një fushatë e rezistencës civile e udhëhequr nga Opozita Demokratike e Serbisë (DOS), një koalicion i gjerë i partive kundër Millosheviqit. Kjo kulminoi më 5 tetor, kur një gjysmë milion njerëz nga i gjithë vendi u mbledhën në Beograd, duke i imponuar Millosheviqit që të pranojë humbjen. Rënia e Millosheviqit ka përfunduar izolimin ndërkombëtar të Jugosllavisë. Millosheviqi u dërgua në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë. DOS njoftoi se RF e Jugosllavisë do të kërkojë të bashkohet me Bashkimin Evropian. Në vitin 2003, Republika Federale e Jugosllavisë u riemërua në Serbi dhe Mali i Zi; BE-ja hap negociatat me vendin e ri për Marrëveshjen e Stabilizimit dhe bashkangjites.

Klima politike e Serbisë mbetet e tensionuar dhe në vitin 2003 kryeministri i Serbisë Zoran Gjingjiq u vra si rezultat i një komploti që erdhi nga qarqet e krimit të organizuar dhe ish-zyrtarët e sigurisë.

Më 21 maj të vitit 2006, Mali i Zi ka mbajtur një referendum për të përcaktuar nëse do t'i jepte fund bashkimit të saj me Serbinë. Rezultatet treguan se 55.4% e votuesve ishin në favor të pavarësisë, që ishte diçka mbi 55% që kërkohej nga referendumi. Më 5 prill të vitit 2006, Kuvendi Kombëtarë i Serbisë e ka deklaruar Serbinë pasardhës ligjor i ish-Bashkimit të shtetit. Krahina e Kosovës ka shpallur deklaratën e njëanshme të pavarësisë nga Serbia më 17 shkurt të vitit 2008. Serbia menjëherë e dënoi deklaratën dhe vazhdon të mohojë shtetin e Kosovës. Deklarata ka shkaktuar reagime të ndryshme nga komunitarë ndërkombëtar - disa e kanë mbështetur, ndërsa të tjerët e dënuan këtë veprim të njëanshëm. Bisedimet neutrale ndërmjet Serbisë dhe Kosovës mbahen në Bruksel me ndërmjetësimin e BE-së. Në prill të vitit 2008, Serbia u ftua për t'u bashkuar me programin e intensifikuar të dialogu me NATO, pavarësisht nga çarja diplomatike me aleancën mbi Kosovën. Serbia ka aplikuar zyrtarisht për anëtarësim në BE më 22 dhjetor të vitit 2009 dhe mori statusin e kandidatit më 1 mars të vitit 2012, pas një vonese në dhjetor të vitit 2011. Pas një rekomandimi pozitiv të Komisionit Evropian dhe Këshillit Evropian në qershor të vitit 2013, negociatat për t'u bashkuar me BE-në kanë filluar në janar të vitit 2014. Në korrik të vitit 2016, BE-ja hapi kapitujt 23 dhe 24 në kuadër të procesit të negociatave me Serbinë.

## 4.2. Korniza e aplikueshme ligjore - nga normat ndërkombëtare tek ligjislacioni i vendit

### 4.2.1. Traktatet ndërkombëtare

Republika Federale e Jugosllavisë u bë pasardhëse e ish-RSFJ më 26 prill të vitit 2001, duke ruajtur anëtarësimin e saj në traktatet ndërkombëtare, dhe u pranua përsëri nga Kombet e Bashkuara. Republika e Serbisë, si pasardhëse ligjore e Unionit të Serbisë dhe Malit të Zi, bëri të njëjtën gjë në bazë të Vendimit të Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë nga 5 qershori 2006.

Të gjitha traktatet e mëdha të të drejtave universale të njeriut janë të detyrueshme për Serbinë, duke përfshirë: Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe dy Protokollet e saj, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave dhe Protokollin e saj, Konventa për të Drejtat e fëmijëve dhe dy Protokollet e saj (për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura dhe mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve), Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Genocidit, Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degradues apo Ndëshkimit dhe Protokollin e saj, Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokollin e saj, dhe Konventën për Mbrojtjen e gjithë Personave nga Zhdukjet me Forcë.

Shtetasit e Serbisë kanë të drejtë të paraqesin ankesat individuale tek të gjithë Komitetet e OKB-së, të cilët janë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të konventave të të drejtave të njeriut, me përjashtim të Komitetit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe të Drejtat Kulturore, duke pasur parasysh se Serbia nuk e ka ratifikuar Protokollin Opsional të Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Serbia ka dështuar të pranojë të drejtën e paraqitjes së ankesave kolektive Komitetit Evropian të të Drejtave Sociale sipas Kartës Sociale Evropiane të Rishikuar. Për më tepër, qytetarët e Serbisë kanë të drejtë të paraqesin ankesat Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Serbia ka ratifikuar shumë instrumente rajonale. Serbia dhe Mali i Zi kanë ratifikuar KEDNJ dhe 14 Protokollet e saj më 26 dhjetor të vitit 2003. Serbia nuk ka pasur ndonjë rezervë për KEDNJ që nga viti 2011.

Serbia është e detyruar nga konventat ndërkombëtare të mëposhtme të cilat ndalojnë dënimin me vdekje (datat e ratifikimit jepen në kllapa): Protokollin e Dytë Opsional të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (6 shtator 2001) dhe Protokollin nr. 6 dhe nr. 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (3 mars 2004). Sipas nenit 24 të Kushtetutës së Serbisë (2006): „Jeta e njeriut është e pacenueshëm. Nuk do të ketë dënim me vdekje në Republikën e Serbisë „.

Serbia është e lidhur me traktatet e mëposhtme:

- Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, ratifikuar më 12 mars 2001;
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, ratifikuar më 12 mars 2001;

- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, ratifikuar më 12 mars 2001;
- Protokolli i Dytë Opsional i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike me qëllim të heqjes së dënimit me vdekje, ratifikuar më 06 shtator 2001;
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, ratifikuar më 12 mars 2001;
- Protokolli Opsional i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, të miratuar më 31 korrik 2003;
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtuese, ratifikuar më 12 mars 2001;
- Protokolli Opsional i CAT, Serbia dhe Mali i Zi e kanë ratifikuar në dhjetor 2005;
- Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, ratifikuar më 12 mars 2001;
- Protokolli Opsional i KDF-së mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura, ratifikuar më 31 janar 2003;
- Protokolli Opsional i KDF-së mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve, ratifikuar më 10 tetor 2002;
- Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, ratifikuar më 31 korrik 2009;

#### **4.2.2. Anëtarësimi në Këshillin e Evropës**

Pas ndryshimeve demokratike në vjeshtë të vitit 2000, Republika Federale e Jugosllavisë ka aplikuar për anëtarësim në Këshillin e Evropës. Në rezolutën e sajë 15 mbi Republikën Federative të Jugosllavisë me 22 nëntor të vitit 2000, Komiteti i Ministrave e pranoi kërkesën dhe e ftoi Kuvendin parlamentar që të jap opinionin e vet mbi këtë aplikim në përputhje me Rezolutën Statutore (51) 30.

Për shkak të nevojës që të redefinohen marrëdhëniet në mes dy njësive federale, Serbia dhe Mali i Zi nënshkruan një marrëveshje me 14 mars të vitit 2002 që çoi në miratimin e Kartës Kushtetuese në shkurt të vitit 2003, dhe krijimin e Shtetit të përbashkët të Serbisë dhe Malit të Zi, si pasardhës të RFJ-së .

Gjatë procedurës së pranimit, PA tërësisht shqyrtoi situatën në vend dhe ka ndjekur nga afër zhvillimet. Një komitet ad hoc ka vëzhguar zgjedhjet parlamentare të Serbisë më 23 dhjetor të vitit 2000 dhe në Mal të Zi në prill të vitit 2001. Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës (CLRAE) gjithashtu ka vëzhguar zgjedhjet në komuna.

Serbia u bë shteti i 45 anëtare e Këshillit të Evropës me 3 mars të vitit 2003, dhe në të njëjtin vit ka ratifikuar Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut.

#### **4.2.3. Dënimi me vdekje**

Parlamenti i Serbisë me 26 shkurt 2002 ka miratuar ndryshimet e Kodit Penal në lidhje me heqjen e dënimit me vdekje. Dënimi i fundit është kryer me pushkatim më 14 shkurt 1992, dhe dënimet e fundit me vdekje u shpallën në vitin 2001.



#### 4.2.4. Gjyqësia

Kuvendi Kombëtar i Serbisë ka miratuar Strategjinë Kombëtare të Reformës Gjyqësore për periudhën 2013-2018.

Disa prej udhëzimeve më të rëndësishme për veprimtarinë e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me reformën e sistemit të drejtësisë janë: përgatitja, miratimi dhe zbatimi i masave legislative dhe institucionale që synojnë përmirësimin dhe përmirësimin në shkallën më cilësore të pavarësisë dhe efektivitetit të sistemit gjyqësor; harmonizimi i legjislacionit të Serbisë me atë të BE-së; Përafrimi me standardet e sotme të legjislacionit civil dhe penal; si dhe përshtatja e organizimit dhe mënyrës së punës të profesioneve të lira gjyqësore.

Qëllimi i Strategjisë është: „Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të drejtësisë; forcimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së gjyqësorit me qëllim të forcimit të shtetit ligjor, demokracisë dhe sigurisë juridike; sjellja e drejtësisë më afër qytetarëve; dhe rivendosja e besimit në sistemin gjyqësor „.

Reforma e sistemit gjyqësor në Republikën e Serbisë është e bazuar në pavarësinë, paanshmërinë dhe cilësinë e drejtësisë, profesionalizmin, përgjegjshmërinë dhe efikasitetin. Këto parime sigurojnë një kornizë për krijimin, zhvillimin dhe organizimin e institucioneve të drejtësisë për të krijuar një sistem gjyqësor që mund të mbrojë plotësisht të drejtat e të gjithë qytetarëve, me një qëllim të përhershëm të përmirësimit të zbatimit konkret të sistemit në çdo fazë të zhvillimit të gjyqësisë dhe praktikës ligjore.

Rezultatet e arritura në kuadër të reformave të zbatuara më parë, të përcaktuara në dokumentet e mësipërme, si dhe problemet e gjyqësorit që duhet të zgjidhen urgjentisht, janë:

- Riintegrimi në sistemin gjyqësor të gjykatësve dhe prokurorëve publikë të cilët janë kthyer në detyrë në bazë të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, si dhe shqyrtimi i rrjetit gjyqësor;
- Adresimi i lëndëve të mbetura;
- Zgjidhja e lëndëve për gjykim brenda afatit të arsyeshëm;
- Përmirësimi i statusit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Shtetit Prokurorial, si dhe rregullimin normativ të përgjegjësive të këtyre dy organeve;
- Harmonizimi i praktikës gjyqësore; dhe
- Krijimi i një sistemi uniform të e-Drejtësisë.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Serbisë, sistemi gjyqësor përbëhet nga gjykatat e përgjithshme dhe gjykatat e juridiksionit të veçantë.

Kushtetuta thotë se gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm janë: gjykatat themelore, gjykatat e larta, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Kasacionit.

– Gjykata Themelore themelohet për territorin e një qyteti, apo një ose më shumë komunave. Sipas njësive dhe fushave të gjykatave dhe prokurorive në territorin e Republikës së Serbisë, ekzistojnë gjithsejt 34 gjykata themelore. Me përjashtim të Gjykatës Themelore të Parë dhe Gjykatës Themelore në Bor, të gjitha gjykatat kanë nga dy deri në dhjetë njësi gjyqësore jashtë njësive të tyre në të cilën gjykojnë dhe marrin veprimet e tjera gjyqësore.



- Gjykatat e larta janë vendosur për zonën e një apo më shumë gjykatave themelore, në bazë të gjykatës më të lartë të parashikuar me ligj (neni 14 paragrafi 1 dhe neni 15 paragrafi 3 i Ligjit për Organizimin e Gjykatave). Në Serbi ka 26 gjykata të larta.
- Gjykata e Apelit themelohet për territorin e disa gjykatave të larta dhe është drejtpërdrejt mbi Gjykatën e lartë dhe atë themelore (neni 14. paragrafi 3 dhe neni 2, paragrafi 15 i Ligjit për Organizimin e Gjykatave). Ekzistojnë 4 gjykata të apelit me bazë në Beograd, Kragujevac, Nish dhe Novi Sad.
- Gjykata e Lartë e Kasacionit është gjykata më e lartë e republikës dhe eprori i drejtpërdrejtë në gjykatën më të lartë të apelit.
- Gjykatat e specializuara janë gjykatat tregtare, Gjykata Ekonomike e Apelit, gjykatat për kundërvajtje, Gjykata e Lartë për Kundërvajtje dhe Gjykata Administrative.
- Gjykata Ekonomike themelohet për territorin e një ose më shumë qyteteve, apo më shumë komunave (neni 2 paragrafi 14. Ligji për Organizimin e Gjykatave). Ekzistojnë 16 gjykata komerciale.
- Gjykata Ekonomike e Apelit themelohet për territorin e Republikës së Serbisë. Është drejtpërdrejtë Gjykatë e Lartë për Gjykatën Ekonomike (neni 13, paragrafi 1 dhe nenin 15 paragrafi 2 i Ligjit).
- Gjykata për Kundërvajtje themelohet për territorin e qytetit, gjegjësisht një ose më shumë komuna. Gjykata për kundërvajtje mund të ketë departamente jashtë selisë. Në Republikën e Serbisë ka 45 Gjykata për Kundërvajtje.
- Gjykata e Lartë për Kundërvajtje themelohet për territorin e Republikës së Serbisë, me seli në Beograd dhe me departamentet në Kragujevac, Nish dhe Novi Sad.
- Gjykata Administrative themelohet për territorin e Republikës së Serbisë, me seli në Beograd dhe me departamentet në Kragujevac, Nish dhe Novi Sad. (Neni 13, paragrafi 1 i Dekretit mbi konfliktet administrative, dhe neni nr. 8).

#### 4.2.5. Legjislacioni i vendit dhe ndalimi i torturës

##### Kushtetuta

Kushtetuta aktuale e Republikës së Serbisë u miratua më 8 nëntor të vitit 2006, pas një referendumi. Miratimi i kushtetutës së re u bë e domosdoshme në vitin 2006, kur Serbia u bë e pavarur pas shpërbërjes së Malit të Zi dhe shpërbërjes së shtetit Serbia dhe Mali i Zi. Kushtetuta përmban një parathënie, 206 nene, 11 pjesë, dhe nuk ka ndryshime. Pjesa e dytë e Kushtetutës është përkushtuar të drejtave dhe lirive të njeriut. Nuk ka dënim me vdekje në Serbi (që nga viti 2002). Gjithashtu, Kushtetuta garanton se askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose degradues, apo për eksperimente mjekësore ose shkencore, pa pëlqimin e tyre të lirë.

*E drejta për liri dhe siguri:* Gjithkush ka të drejtën e lirisë dhe sigurisë. Heqja e lirisë është e lejuar vetëm për arsye dhe në procedurë të përcaktuar me ligj. ... Çdo dënim i cili përfshin privim të lirisë mund të vendoset vetëm nga gjykata.

*Trajtimi i personave të privuar nga liria:* personat e privuar nga liria duhet të trajtohen me humanizëm dhe respekt për dinjitetin e personalitetit të tij/saj. Neni 25 i Kushtetutës thotë

qartë se është e ndaluar të ushtrohet çdo dhunë ndaj personit të privuar nga liria. Integriteti fizik dhe mendor është i pacenueshëm. Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose degradues, apo për eksperimente mjekësore dhe të tjera, pa pëlqimin e tyre të lirë.

## **Kodi Penal**

Kodi i ri Penal u miratua në vitin 2005. Që atëherë ka qenë i ndryshuar me ligjet nr. 85, nr. 88 dhe nr. 107 në vitin 2005; ligjet nr. 72 dhe nr. 111 në vitin 2009; ligjin nr. 121 në vitin 2012; ligjin nr. 104 në vitin 2013; dhe ligjin nr. 108 në vitin 2014.

Ka disa nene dhe kapituj të rëndësishëm lidhur me ekzekutimin e sanksioneve penale dhe të kushteve të drejtave të njeriut në burgje: Neni 136 –nxjerrje me dhunë të rrëfimit; Neni 137 –Abuzimi dhe tortura;

*Kodi Penal i vitit 2005* (Gazeta Zyrtare nr. 85, 2005; nr. 88, 2005; nr. 107, 2005; nr. 72, 2009; nr. 111, 2009; nr. 121, 2012; nr. 104, 2013; no. 108, 2014).

– Nuk ka vepër penale apo dënim pa ligj (neni 1):

– Abuzimi dhe tortura (neni 137):

(1) Kushdo që keqtrajton tjetërin ose sillet ndaj një personi në mënyrë poshtëruese dhe degraduese, dënohet me gjobë ose burgim deri në një vit.

(2) Kushdo që shkakton ankth tek personi tjetër, me qëllim për të marrë prej tij ose një tjetri informata ose një rrëfim, ose për të frikësuar atë ose një palë të tretë, ose për të ushtruar presion mbi personat e tillë, ose nëse bëhet nga motive të bazuar në çfarëdo forme të diskriminimit, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

(3) Nëse vepra penale e përcaktuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni kryhet nga personi zyrtar në kryerjen e detyrës, një person i tillë do të dënohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 me burgim nga tre muaj deri në tre vjet, ndërsa për veprën penale nga paragrafi 2 i këtij neni me burgim prej një deri në tetë vjet.

– *Kodi i Procedurës Penale* (Gazeta Zyrtare e RS, nr. 72/2011, 101/2011, 121/2012, 32/2013, 45/2013 dhe 55/2014):

Korniza ligjore e vendosur në Kodin e ri të Procedurës Penale, e cila hyri në fuqi më 1 tetor 2013, është më pak e favorshme se ajo e fundit, kur është fjala për ndjekjen penale të autorëve të torturës dhe keqtrajtimit. Gjegjësisht, Kodi i ri parashikon procedurë të shkurtër, dmth. përjashton hetime të detyrueshme, për krimet që kërkojnë deri në tetë vjet burgim, të tilla si tortura dhe keqtrajtimi, si dhe forma e thjeshtë e krimit të nxjerrjes me dhunë të rrëfimit. Për këtë arsye, prokurorët kanë detyrë që të kryejn hetime vetëm në raste të formave të rënda të krimit të nxjerrjes me dhunë të rrëfimit, ndërsa në rastet e tjera të torturës dhe keqtrajtimit ata mund të ndërmarrin veprime individuale me nismën e tyre ose me urdhër të gjykatës.

– *Ligji Mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale* (LEPS, 2005, 2009) (Gazeta Zyrtare e RS, nr. 85/2005 dhe 72/2009):

Fusha e zbatimit të sanksioneve penale në Republikën e Serbisë është e rregulluar në mënyrë normative me: Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LEPS, 2005, 2009), të miratuar në vitin 2005 dhe të ndryshuar në vitin 2009; Ligji për Ekzekutimin e dënimit me

burg për veprat penale të Krimin të Organizuar (LEPSCOC, 2009) të miratuar në vitin 2009; Ligji për kryesit e mitur të veprave penale dhe mbrojtjen Penal të Miturve (LJCOCPM, 2005) të miratuar në vitin 2005; Dekreti mbi themelimin e institucioneve për zbatimin e sanksioneve institucionale në Republikën e Serbisë; dhe Rregullat e veçanta të Shtëpisë për burgje të sigurisë maksimale dhe burgje të mbyllura, burgje të hapura, burgjet e grave, burgjet e qarkut dhe objektet e paraburgimit dhe rregullativave tjera përkatëse nënligjore.

### 4.3. Institucioni Kombëtar për të Drejtat e Njeriut, Mekanizmi Kombëtar Parandalues dhe mekanizmat e tjerë për monitorim

#### 4.3.1. Institucioni Kombëtar për të Drejtat e Njeriut – Avokati i Popullit

Ligji për Mbrojtësin e Qytetarëve („Gazeta zyrtare e RS”, nr. 79/2005 dhe 54/2007) thekson se Mbrojtësi i qytetarëve është organ i pavarur dhe autonom shtetërore, i cili mbron të drejtat e qytetarëve dhe kontrollon ligjshmërinë dhe rregullsinë e punës së kryer nga ana e organeve të administratës qeveritare, organeve përgjegjës për mbrojtjen ligjore të drejtave të pronës dhe interesave të Republikës së Serbisë, si dhe të organeve të tjera dhe organizatave, ndërmarrjeve dhe institucioneve të besuara me ushtrimin e kompetencave publike. Në kryerjen e detyrave të tij, Mbrojtësi i qytetarëve vepron brenda kufijve të Kushtetutës, ligjit, rregulloreve dhe akteve të tjera nënligjore, si dhe traktateve ndërkombëtare të ratifikuara dhe rregullave përgjithësisht të pranuarra të së drejtës ndërkombëtare.

Para bërjes së ankesës, aplikantit i kërkohet të bëjë një përpjekje për të mbrojtur të drejtat e tyre me anë të procedurave përkatëse ligjore.

Avokati i Popullit funksionon në mënyrë të pavarur dhe askush nuk ka të drejtë të ndikojë në punën dhe veprimet e tij. Avokati i Popullit zgjidhet nga Kuvendi Kombëtarë i Republikës së Serbisë për një periudhë pesë vjeçare dhe është përgjegjës për punën e tij në Kuvend. Avokati i Popullit u bë pjesë e rendit juridik të Republikës së Serbisë në vitin 2005, kur Kuvendi miratoi Ligjin për Avokatin e Popullit. Përzgjedhja dhe kompetencat e Avokatit të Popullit janë të rregulluara me Kushtetutën e Republikës së Serbisë nga viti 2006. Avokati i pare i Popullit Sasha Jankoviç mori detyrën më 23 korrik 2007, pas dhënies së betimit para deputetëve të Kuvendit Kombëtarë. Avokati i Popullit ka katër deputetë të cilët janë të zgjedhur nga Kuvendi Kombëtarë, dhe të cilët ndihmojnë Avokatin e Popullit në kryerjen e detyrave.

Shërbimi Ekspert i Avokatit të Popullit, i kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm, merret me ankesat dhe kërkesat, mbledh dokumentet dhe përcakton të dhënat e tjera të nevojshme për të vlerësuar ankesat. Ai gjithashtu bën edhe punët ligjore, financiare, të zyres dhe punë të tjera të nevojshme për të kryer detyrat e Avokatit të Popullit. Shërbimi Ekspert i Avokatit të Popullit ka filluar punën e tij më 24 dhjetor të vitit 2007 në një adresë të përkohshme në Beogradin e Ri, rruga Milutina Milankovića nr. 106. Nga 4 maji 2010, adresa e re e Avokatit të Popullit është Deligradska nr. 16, Beograd.

– *Raporti vjetor i Mbrojtësit të Qytetarëve për vitin 2014*<sup>23</sup>

– *Raporti vjetor i Mbrojtësit të Qytetarëve për vitin 2015*<sup>24</sup>

23 <http://bit.ly/1RUuuvQ> (verzioni anglisht);

24 <http://bit.ly/23hudxw> (në dispozicion vetëm në gjuhën serbe);

### Avokati i Popullit Krahinor

Avokati i Popullit Krahinor është organ i pavarur dhe autonom i Krahinës Autonome të Vojvodinës, e cila mbron të drejtat e qytetarëve dhe mbikëqyr punën e organeve krahinore administrative, ndërmarrjeve publike dhe institucioneve që ushtrojnë kompetenca administrative dhe publike, në bazë të vendimeve dhe akteve të tjera ligjore të KA të Vojvodinës. Në bazë të vendimit të ri të Kuvendit Krahinor për Avokatin e Popullit krahinor, Avokati i Popullit Krahinor ka katër deputetë nga të cilët zgjidhet njëri nga fusha e të drejtave të pakicave, të drejtave të fëmijëve dhe barazisë gjinore.

Vendimi mbi themelimin e institucionit të Avokatit të Popullit Krahinor u miratua në dhjetor të vitit 2002. Avokati i parë i popullit të Vojvodinës u zgjodh më 24 shtator të vitit 2003, dhe filloi të punojë në janar të vitit 2004. Selia e institucionit gjindet në Novi Sad.

- *Raporti vjetor i Avokatit të Popullit Krahinor për vitin 2015<sup>25</sup> na jep të dhëna mbi punën dhe kompetencat e tij.*

#### 4.3.2. Mekanizmi Kombëtar Parandalues në Serbi

Republika e Serbisë ka nënshkruar OPCAT më 25 shtator të vitit 2003; miratoi Ligjin për Ratifikim më 1 dhjetor 2005; dhe u bë një Shtet palë e OPCAT më 26 shtator 2006.

Në përputhje me ndryshimin e Ligjit për ratifikimin e Protokollit Opsional, miratuar më 28 korrik 2011, në seancën e Parlamentit të Serbisë, Avokatit të Popullit i është dhënë autoriteti për të kryer detyrat e MKPT.

Për të arritur bashkëpunimin në kryerjen e mekanizmit kombëtar për parandalimin e torturës, Avokati i Popullit me Avokatin e Popullit Krahinor të Krahinës Autonome të Vojvodinës nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit.

Modeli i MKPT në Republikën e Serbisë është përcaktuar nga ligji përkatës. Ky ligj përcakton se Mbrojtësi i qytetarëve do të kryejë detyrat e MKPT në bashkëpunim me Avokatët e Popullit të krahinave autonome dhe ato shoqata qëllimi i të cilve është, përcaktuar me statut, promovimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Ligji përcakton se Mbrojtësi i qytetarëve do të kryejë funksionin e MKPT-së për një numër arsyesh.

Gjegjësisht, mandati i Mbrojtësit të qytetarëve në bazë të Ligjit mbi Mbrojtësin e qytetarëve mbulon detyrat dhe kompetencat e MKPT të përcaktuara me OPCAT, duke përfshirë vizitat në institucionet në të cilat mbahen personat e privuar nga liria, intervista me ta, qasje në të dhëna, duke bërë rekomandime për autoritetet kompetente, informimin e publikut të gjerë në lidhje mbi praninë e torturës dhe promovimin e statusit të personave të privuar nga liria.

Për më tepër, është vërejtur se Mbrojtësi i qytetarëve ka ndjekur aktivitete intensive parandaluese ndërsa ekipi i tij i ekspertëve, dmth „Mekanizmi për Parandalim të Mbrojtësit të qytetarëve”, në periudhën e dy (2) viteve të fundit u kushtoi vizita stacioneve të policisë, njësisë të paraburgimit, burgjeve, institucioneve të mirëqenies sociale të tipit stacionarë, institucioneve psikiatrike, strehimoreve për azil-kërkuesit, etj.

---

25 <http://bit.ly/1RUJbin>



Përveç kësaj, Mbrojtësi i qytetarëve është i njohur si organ që vepron në bazë të Parimeve të Parisit, dhe kjo është arsyeja pse në prill të vitit 2010 ka fituar statusin „A” si Institucioni Kombëtarë i të Drejtave të Njeriut (IKDNJ) brenda sistemit të Kombeve të Bashkuara.

Arsyeja e bashkëpunimit në mes të Mbrojtësit të qytetarëve, Ombudsmanëve të krahinave autonome dhe shoqatave në kryerjen e detyrave MKPT është se Avokati i Popullit të Krahinës Autonome të Vojvodinës dhe shoqatave të shumta të qytetarëve kanë, për shumë vjet tani, qenë jashtëzakonisht aktive në mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria dhe në parandalimin e torturës. Gjithashtu, ata kanë eksperiencë në monitorimin e institucioneve ku mbahen personat e privuar nga liria.

Aktualisht në krye të MKPT është deputet i Mbrojtësit të qytetarëve Milosh Janković.

Mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës kryen vizitat në institucionet ku personat janë të privuar nga liria (burgje, institucione për të mitur dhe institucionet sociale, objektet shëndetësore, stacionet policore, qendrat për azile, etj.).

Mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës ka qasje të pakufizuar dhe pa paralajmërim dhe në çdo kohë mundet t’i vizitoj të gjitha vendet ku ka apo mund të jenë personat e privuar nga liria; ai ka të drejtë në intervistë private me të gjithë personat e privuar nga liria dhe të gjithë zyrtarët që mund të kenë informacione të rëndësishme për trajtimin e personave të privuar nga liria; ai ka qasje në të gjithë dokumentacionin në lidhje me këto persona; ai ka të drejtë të bëjë rekomandime autoriteteve kompetent për të përmirësuar trajtimin e personave të privuar nga liria dhe përmirësimin e kushteve në të cilat ato jetojnë, si dhe të drejtë të paraqesë propozime dhe mendimin e vet në lidhje me Aktet ligjore ekzistuese ose të propozuara.

MKPT përcakton objektivat kryesore dhe ka një dialog bashkëpunues me autoritetet shtetërore; bashkëpunon me akterë të ndryshëm të sektorit civil (OJQ-të, akademikë, sindikatat ...), por edhe me viktimat dhe ish të burgosurit.

MKPT është i detyruar të dorëzojë raporte autoriteteve në lidhje me vizitat e tyre në institucionet, së bashku me rekomandimet se si duhen zgjidhur problemet ekzistuese. Raporti vjetor i dorëzohet Nënkomitetit për Parandalimin e Torturës. Të gjitha raportet e MKPT-së janë të disponueshme për publikun:

- Lajmet dhe raportet e MKPT nga të gjitha vizitat<sup>26</sup>
- Rekomandimet e MKPT-së<sup>27</sup>
- Raportet vjetore<sup>28</sup>
- Raporti vjetor për 2014<sup>29</sup>

» *Mangësitë*

As kapaciteti i organeve as burimet në dispozicion të tyre nuk janë të tilla për t’u mundësuar atyre që të kenë një pasqyrë të detajuar në problemet që ekzistojnë në çdo vend dhe për t’u lejuar atyre komunikim me autoritetet shtetërore. Këtë e parandalon organi i caktuar i shtetit për të arritur informacione të plota dhe të besueshme për trajtimin e personave të privuar nga liria në një vend të caktuar.

26 [http://www.npm.lis.rs/index.php?option=com\\_content&view=category&layout=blog&id=22&Itemid=13](http://www.npm.lis.rs/index.php?option=com_content&view=category&layout=blog&id=22&Itemid=13)

27 [http://www.npm.lis.rs/index.php?option=com\\_content&view=category&layout=blog&id=27&Itemid=18](http://www.npm.lis.rs/index.php?option=com_content&view=category&layout=blog&id=27&Itemid=18)

28 [http://www.npm.lis.rs/index.php?option=com\\_content&view=category&layout=blog&id=31&Itemid=22](http://www.npm.lis.rs/index.php?option=com_content&view=category&layout=blog&id=31&Itemid=22)

29 [http://www.npm.lis.rs/attachments/135\\_Izv%20NPM%202014%20engl.pdf](http://www.npm.lis.rs/attachments/135_Izv%20NPM%202014%20engl.pdf) (verzióni anglisht);



### 4.3.3. Mekanizmat e tjerë të monitorimit

#### Institucionet e tjera brenda qeverisë që mbikëqyrin vendet e paraburgimit

– Gjyqtari për ekzekutim: bazuar në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, mbron të drejtat e të burgosurve, të dënuarve, personave të cilëve u është imponuar masa e sigurimit e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe izolim në një institucion mjekësor, trajtimin e detyrueshëm të narkomanve ose trajtimi i detyrueshëm i alkoolistëve kur trajtimi është kryer në institutin; mbikëqyr ligjshmërinë e ekzekutimit të sanksioneve penale dhe siguron barazinë e këtyre personave para ligjit. Gjyqtari gjithashtu vendos mbi: 1) Mbrojtjen e të drejtës së të paraburgosurve për të apeluar dhe bën kërkesën për mbrojtje gjyqësore të personave të dënuar, personat të cilëve u është imponuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe izolim në një institucion mjekësor, trajtim të detyrueshëm të narkomanve ose alkoolistëve kur trajtimi i detyrueshëm kryhet në Institucion; 2) mbron të drejtat e të dënuarve duke vendosur për ankesën kundër guvernatorit të burgut ose Bordit të Drejtorëve, në rastet e përcaktuara me ligj; 3) raste të tjera të parashikuara me ligj.

– Departamenti për Mbrojtjen dhe ushtrimin e të drejtave në kuadër të Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale: Kryen detyra në lidhje me falje, amnesti, transferim dhe vendosje të mëvonshëm të personave të privuar nga liria, dhe të ndryshimeve të akteve të detyrës; bën ndërprerjen e dënimit me burgim dhe punën e të burgosurve jashtë institucionit; merret me çështjet që lidhen me peticionet dhe ankesat e personave të privuar nga liria, kryen aktivitetet që lidhen me përcaktimin e ankimeve ndaj vendimeve të Bordit të Drejtorëve dhe vendimet e menaxherit. Kryen detyra dhe përgatit aktet që lidhen me vendosjen e të burgosurve; përgatit zgjidhje për një lirim të parakohshëm të të burgosurve dhe kryen të gjitha aktivitetet që lidhen me mundësin e mbrojtjes administrativo-ligjore të të burgosurve. Regjistron të dhëna për përdorimin e forcës, vetë-lëndimit, sanksionet disiplinore dhe vdekjet e të burgosurve nga të gjitha burgjet.

#### Grupet e shoqërisë civile për monitorim të të gjithë institucioneve të përmendura

Gjithsejt nëntë organizata joqeveritare u zgjodhën të marrin pjesë në Mekanizmin Kom-bëtatë Parandalues të organizuar nga zyra e Avokatit të Popullit, me fokus të veçantë në fushat ku mund të vij deri tek rastet e torturës<sup>30</sup>. Ato marrin pjesë në vizita në terren, të lajmëruara apo të palajmëruara, pregadisnin raporte në fund të vizitave dhe reagojnë në çdo ankesë e cila ju drejtohet.

Këtu kemi shënuar organizatat e intervistuar gjatë pregaditjes së këtij raporti.

- Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (yih.org)
- Komiteti i Avokatëve për të Drejtat e Njeriut - YUCOM (yucom.org.rs)
- Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (helsinki.org.rs)
- Qendra e Beogradit për të Drejtat e Njeriut (bgcentar.org.rs)

30 [http://www.npm.lis.rs/index.php?option=com\\_content&view=category&layout=blog&id=26&Itemid=17](http://www.npm.lis.rs/index.php?option=com_content&view=category&layout=blog&id=26&Itemid=17)  
NB kjo web faqe jep njoftim mbi nënshkrimin e marrëveshtjes me OIQ të ndryshme dhe kjo procedurë është kryer në vitin 2015.

#### 4.4. Përgjigjet – Rastet e torturës

Në nenin e 3, ndalimi i torturës (Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut), tetë vendime janë dhënë nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Shkeljet u gjenden në këto pesë raste:

- Habimi dhe të tjerët kundër Serbisë, vendimi i 3 qershorit 2014;
- Lakatos dhe të tjerët k. Serbisë, vendimi i 7 janarit 2014;
- Hajnaj k. Serbisë, vendimi i 19 qershorit 2012;
- Stanimiroviq k. Serbisë, vendimi i 18 tetorit 2011;
- Milanoviq k. Serbisë, vendimi i 14 dhjetorit 2010.

Nga 1 tetori i vitit 2013 deri me 30 qershor 2015 në prokurorinë themelore publike janë paraqitur 259 ankesa për vepër penale torturë dhe keqtrajtim kundër 417 personave (nga të cilët 121 kundër policëve dhe të punësuarve të Shërbimit të Sigurimit të burgut) dhe tetë ankesa kundër 19 personave për vepër penale zhvajtje e rrëfimit. Procesi është në vazhdim e sipër në lidhje me 34 aplikime, ndërsa 80 ankesa penale janë hedhur poshtë, dhe vetëm gjashtë aktakuza janë ngritur dhe një marrëveshje është bërë për pranimin e krimit. Fati i ankesave penale për zhvajtje të rrëfimit e ngritur kundër 19 policëve është e ngjashme, pra, shtatë u hodhën poshtë dhe sipas një aktakuze procesi është ende në zgjatje.<sup>31</sup>

#### 4.5. Vendet e privimit të lirisë

Në bazë të dhënave në dispozicion, ekzistojnë 28 institucione penale në Serbi, duke përfshirë:<sup>32</sup>

- 1 burg i sigurisë maksimale (KPZ Pozharevac–Zabella);  
Kapaciteti/Numri aktual:  
Të dënuar - 820/1513,  
Të ndaluar - 200/35,  
Shkelës të ligjit - 40/12
- 2 burgje të tipit të mbyllur (KPZ Nish dhe KPZ Sremska Mitrovica);  
Kapaciteti/Numri aktual:  
Të dënuar - 1327/1343,  
Të ndaluar - 135/52,  
Shkelës të ligjit - 25/31
- 4 burgje të tipit të hapur (KPZ-të Padinska Skella, Sombor, Quprija dhe Shabac);  
Kapaciteti/Numri aktual:  
Të dënuar - 413/276,  
Të ndaluar – none,  
Shkelës të ligjit - 40/16

31 Të Drejtat e Njeriut në Serbi: Raporti vjetor për vitin 2015, Qendra për të Drejtat e Njeriut Beograd:<http://bit.ly/1TYKKIO>;

32 Konsultuar: <http://www.uiks.mpravde.gov.rs/lt/articles/ustanove-za-izvršenje-krivicnih-sankcija/okruzni-zatvori/>

- 1 burg për gra i tipit gjysëm të hapur (KPZ për gra- Pozharevac);  
Kapaciteti/Numri aktual:  
Të dënuar - 180/280,  
Të ndalur – none,  
Shkelës të ligjit - 16/11
- 1 institucion korrektues për të mitur dhe kundërvajtës të rinj i tipit të mbyllur (KPZ Valevo);  
Kapaciteti/Numri aktual:  
Të dënuar - 241/269,  
Të ndaluar - 24/11,  
Shkelës të ligjit - 25/15
- 1 spital special i burgut i tipit të mbyllur (KPD Spitali Beograd);  
Kapaciteti/Numri aktual:  
Të dënuar – 756/526,  
Të ndaluar – 43,  
Shkelës të ligjit - 10
- 1 objekt edukativo korigjues i tipit gjysëm të hapur (VPD Krushevac);  
Kapaciteti/Numri aktual:  
Të dënuar – 310/24,  
Ekzekutimi i masave edukuese – 201
- 17 burgje të qarkut (në Beograd, Vranje, Zaječar, Zrenjanin, Kragujevac, Kraljevo, Krushevac, Leskovac, Negotin, Novi Pazar, Novi Sad, Pančevo, Prokuplje, Smederevo, Subotica, Uzhic dhe Čačak)
- Gjithashtu ekzistojn rreth 168 njësi të paraburgimit dhe stacioneve policore në Serbi. Të gjitha janë nën juridiksionin e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

### **Ministria e Shëndetësisë:**

Nën juridiksionin e Ministrisë së shëndetësisë ekzistojnë 1 insitucion psikiatrik i tipit të mbyllur dhe 5 të tipit gjysëm të hapur për personat me sëmundje mendore:

- Klinika për Sëmundje Psikiatrike „Dr. Llaza Lazareviq”, Beograd (Institucion i tipit të mbyllur);
- Qendra e Shëndetit Mendor në komunitet „Mediana” në Nish;
- Qendra e Shëndetit Mendor në Kragujevac;
- Qendra e Shëndetit në Sombor;
- Qendra e Shëndetit mendor në Kikind;
- Qendra e Shëndetit Mendor në Vrshac;

## 4.6. Fushat e shqetësimit

### Institucionet ku më së shpeshti ndodh tortura

Shumica e institucioneve në të cilat njerëzit janë të privuar nga liria mund të përshkruhen si johumane dhe joadekuate për paraburgim. Së pari, shumica e institucioneve punojnë në limite të kapaciteteve të veta apo edhe përtej limiteve. Kështu që nuk është i përmbushur kushti i parë-sigurimi i hapsirës së mjaftueshme. Së dyti, shumica e objekteve të burgjeve është shumë i vjetër (datojnë nga fundi i shekullit të 19 dhe fillimi i shekullit të 20).

Mekanizmi Kombëtar Parandalues gjithashtu ka identifikuar parregullsi të caktuara në trajtimin e personave në paraburgim në vitin 2015. Në Raportin përfundimtarë 33, thuhet se policia në shumë raste nuk arriti të sigurojë personave të privuar nga liria informata me shkrim mbi të drejtat e tyre, si dhe në disa raste komesaritetet e ndryshëm të policisë e kanë interpretuar ndryshe fillimin e privimit të lirisë.

### Institucionet e mbipopulluara përtej kapaciteteve të veta

Problemi i mbipopullimit në institucionet korrektuese është ende i pranishëm, veçanërisht në burgjet e Sremska Mitrovica, Pozharevc dhe Nish, por edhe në Burgun e Qarkut në Beograd, ku kushtet mund të klasifikohet si çnjerëzore dhe degraduese.<sup>33</sup>

#### **KPZ Pozarevac–Zabela:**

Kapaciteti/numri aktual:

- Të dënuar - 820/1513
- Në paraburgim - 200/35
- Shkelës të ligjit - 40/12

#### **KPZ Nish:**

Kapaciteti/numri aktual:

- Të dënuar - 1327/1343
- Në paraburgim - 135/52
- Shkelës të ligjit - 25/31

#### **Quprija:**

Kapaciteti/numri aktual:

- Të dënuar - 178/195
- Në paraburgim - 54/41
- Shkelës të ligjit - 12/10

---

33 Të Drejtat e Njeriut në Serbi: Raporti vjetor për 2015, Qendra për të Drejtat e Njeriut Beograd:<http://bit.ly/1TYKKIO>;

**KPZ për gra Pozharevac:**

Kapaciteti/numri aktual:

- Të dënuar - 180/280
- Në paraburgim - none
- Shkelës të ligjit - 16/11

**KPZ Valjevo:**

Kapaciteti/numri aktual:

- Të dënuar - 241/269
- Në paraburgim - 24/11
- Shkelës të ligjit - 25/15

**Zajecar:**

Kapaciteti/numri aktual:

- Të dënuar - 147/150
- Në paraburgim - 32/28
- Shkelës të ligjit - 8/12

**Zrenjanin:**

Kapaciteti/numri aktual:

- Të dënuar - 93/125
- Në paraburgim – 72/80
- Shkelës të ligjit - 10/11

**Kragujevac:**

Kapaciteti/numri aktual:

- Të dënuar - 55/57
- Në paraburgim - 50/37
- Shkelës të ligjit - 15/9

**Novi Sad:**

Kapaciteti/numri aktual:

- Të dënuar - 233/248
- Në paraburgim - 152/158
- Shkelës të ligjit - 43/48

**Smederevo:**

Kapaciteti/numri aktual:

- Të dënuar - 55/59
- Në paraburgim - 77/44
- Shkelës të ligjit -15/18



## Veprimet e policisë gjatë mitingjeve dhe demonstratave si dhe gjatë fazës preliminare të arrestimit

Nga periudha janar deri në nëntor të vitit 2015, gjashtë mitingje janë ndaluar nga juridiksionet policore të Beogradit, dy në Novi Pazar nga juridiksioni i policisë dhe një në Mitrovicën e Sremit. Një ankesë, që është parashtruar tek Ministria e Punëve të Brendshme gjatë kësaj periudhe, u refuzua.<sup>34</sup>

Edhe pse policia ka obligim të nxjerrë vendime individuale dhe të arsyetuara për çdo tubim që ata ndalojnë, Ministri i Punëve të Brendshme të Serbisë, Nebojsa Stefanović gjatë një konference për shtyp tha se policia i ndalon të 5 mitingjet që ishin planifikuar para Kuvendit Kombëtar për të shënuar 20 vjetorin e gjenocidit në Srebrenicë. Këto mitingje ishin planifikuar për të njëjtën ditë, 11 korrik, por në kohë të ndryshme nga ana e: Kuvendit serb Zavetnici, Lëvizjes serbe Dveri, OJQ-së Žene u crnom dhe Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Asociacionit të prindërve të personave të kidnapuar dhe të humbur nga viti 1998 deri në vitin 2000 dhe nga personi fizik- Nikolla Aleksić.

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut ka ftuar edhe deputetët e Kuvendit Kombëtar dhe anëtarët e Qeverisë që me 11 korrik të marrin pjesë në aksionin „Shtatë mijë” dhe në këtë mënyrë të tregojnë dhembshurinë e tyre për viktimat e Srebrenicës dhe të tregojnë solidaritetin njerëzor dhe qytetar me familjet e tyre, së bashku me qytetarët e tjerë të Serbisë. Praktika e Ministrisë të Punëve të Brendshme që publikisht të ndalojë tubimet nuk është e parashikuar me rregulloret ligjore pozitive.

## Akses në kujdes mjekësor për njerëzit e privuar nga liria

Pothuajse të gjitha burgjet kanë një bashkëpunim të ngushtë me qendrat shëndetësore të komunitetit dhe spitalet e përgjithshme në rajonin e tyre ose në qytet. Për të gjitha procedurat e tjera dhe më komplekse, të burgosurit dërgohen në Spitalin e Burgut Special në Beograd. Shqetësimet kryesore janë mungesa e medikamenteve, mungesa e rojeve dhe e personelit mjekësor.

Çështja me medikamente është se ka një listë pozitive të ilaçeve (të cilat burgjet i blejnë) dhe një listë negative e ilaçeve (të burgosurit duhet të i sjellin nga shtëpia). Problemi më i madh është që në listën pozitive nuk ka medikamente kundër dhimbjes.

Së dyti, nuk ka roje të mjaftueshme për përcjellje të të burgosurve të cilët kanë nevojë për analiza shpesh dhe kontrollime mjekësore, të cilat nuk mund të kryhen në spital të burgut. Pasi që momentalisht nuk ekziston politika e punësimit nga Qeveria, por në fuqi është vendimi i qeverisë mbi ndalimin e punësimit, ky problem nuk do të zgjidhet në mënyrë të duhur së shpejti.

Së fundi, mungesa e personelit mjekësor është gjithashtu një problem. Vetëm në disa burgje është i pranishëm mjeku për çdo ditë. Staf i mjekësor (në shumicën e rasteve, përbëhet nga vetëm një anëtarë i personelit) është i pranishëm çdo ditë (në disa raste, vetëm për disa orë) dhe mjeku vjen dy herë në javë, edhe pse mjekët dhe anëtarët e stafit çdo ditë janë në dispozicion përmes thirrjes.

34 Të Drejtat e Njeriut në Serbi: Raporti vjetor për 2015, Qendra për të Drejtat e Njeriut Beograd : <http://www.bgcentar.org.rs/bgcentar/wp-content/uploads/2013/04/Ljudska-prava-u-Srbiji-2015.pdf>;

## Shqetësimet kryesore sipas raportit të SPT të OKB-së dhe Këshillit të Evropës KPT

Një delegacion i Këshillit të Komisionit të Evropës për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor ose Degradues apo Ndëshkimit (KPT) ka kryer një vizitë në Serbi nga data 26 maj deri në 5 qershor 2015. Kjo vizitë u realizua në bazë të programit KPT të vizitave periodike për vitin 2015 dhe ishte vizita e katërt periodike e Komitetit në Serbi.

KPT-ja lëshoi raportin e tij më 24 qershor 2016<sup>35</sup> çka dha një bazë të mirë për veprime të mëtejshme.

Delegacioni i KPT-së vlerësoi progresin e bërë që nga vizita e mëparshme në vitin 2011 dhe masën e implementimit të rekomandimeve të Komitetit- në veçanti, në fushën e ndalimit policor, burgimit dhe garancive ligjore për pacientët në institucionet psikiatrike. Delegacioni edhe njëherë vizitoi Burgun e Qarkut në Beograd dhe Spitalin e Burgut. Më tej, ajo ka vizituar për herë të parë Institucionin Korrektues për të mitur Valjevo, Institucionin Korrektues Nish, dhe Burgun e Qarkut Pançevo. Për herë të parë janë vizituar edhe Spitali Psikiatrik Special Vrshac dhe Shtëpia e Kujdesit Social Veternik në mënyrë që të shqyrtojnë trajtimin, kushtet dhe masat mbrojtëse ligjore që u ofrohen pacientëve dhe banorëve të pranuar në mënyrë të pavullnetshme.

Komiteti kundër Torturës shqyrtoi raportin e dytë periodik të Serbisë (CAT/C/SERB/2) në mbledhjet e 1304 dhe 1307, të mbajtura më 29 dhe 30 prill të vitit 2015 (CAT/C/SR.1304 dhe CAT/C/SR.1307), dhe miratoi vërejtjet e mëposhtme përmbyllëse në mbledhjen e 1322 dhe 1323 (CAT/C/SR.1322 dhe CAT/C/SR.1323) të mbajtur më 12 maj të vitit 2015.<sup>36</sup>

Shqetësimet kryesore në lidhje me situatën në Serbi janë:

- Mungesa e harmonizimit të neneve 136 dhe 137, paragrafët 2 dhe 3, të Kodit Penal që kanë të bëjnë me aktet e torturës, si dhe faktin se ata nuk janë të lidhur me të gjitha elementet e krimit të torturës, siç përcaktohet në nenin 1 të Konventës.
- Raportet që kontrollimet mjekësore të të burgosurve janë kryer shpesh në prani të oficerëve të policisë dhe se shpesh të gjeturat nuk përmbajnë përshkrim të detajuar të lëndimeve ose mendimin e ekspertit.
- Fakti se nga 391 ankesa të torturës dhe keqtrajtimit të paraqitura tek Departamenti i Kontrollit të Brendshëm të Policisë në periudhën prej vitit 2009 deri në mars të vitit 2012, vetëm 15 për qind rezultuan me masa disiplinore, shumica e të cilëve ishin gjoba.
- Mbipopullimi në 5 objekte korrektuese është ende mbi 116 për qind; Delegacioni i KPT-së vuri në dukje kushtet e këqija të paraburgimit, veçanërisht në stacionet e policisë, pastaj mungesa e aktiviteteve të rëndësishme dhe ndërveprimet ndërmjet personave në paraburgim, shërbime të pamjaftueshme të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë këtu kujdesin psikiatrik në burgje.

35 <http://www.cpt.coe.int/documents/srb/2016-21-inf-eng.pdf> (anglisht)

36 Raporti CPT për 2015: <http://bit.ly/1rddud7>;

## 4.7. Rekomandimet

### MKPT Serbia

1. MKPT ka rol të rëndësishëm në monitorimin dhe kontrollin e sistemit të burgjeve në Serbi. Prandaj, MKPT-ja ka fuqi që të përmirësoj komunikimin dhe marrëdhëniet në mes të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale;
2. MKPT duhet të publikojë statistika të hollësishme dhe të mbledhë të dhëna mbi ankesat dhe ti rendis ato sipas gjinisë, gjuhës, vendndodhjes, institucionit, etj për gjendjen aktuale të vendeve të ndalimit në Serbi, të cilat do të ishin në dispozicion të gjithë palëve të interesuara me respektin e duhur të mbrojtjes së të dhënave personale;
3. Me qëllim të funksionimit efikas të MKPT-së, është e nevojshme që të angazhohet një numër i mjaftueshëm i punonjësve ose zyrtarëve të punësuar me njohuri të mjaftueshme në fushën e parandalimit të torturës.
4. Në mënyrë që të sigurohen kushtet për funksionimin efikas të MKPT-së, është e nevojshme që të krijohet një linjë e veçantë buxhetore në kuadër të buxhetit të Mbrojtjes së qytetarëve për nevojat e MKPT-së.

### Në lidhje me parandalimin e torturës:

1. Ulja e mbipopullimit - angazhim për të eliminuar kushtet e mbipopulluara që ekzistojnë në shumë institucione;
2. Përmirësimi i kushteve të përgjithshme në burgje- Qeveria serbe duhet të përmirësojë kushtet themelore fizike në të gjitha burgjet;
3. Nxitja e produktivitetit dhe rehabilitimit social – të investohet në programe të veçanta të rehabilitimit para dhe pas lirimit, gjë që provoi të jetë e suksesshëm në uljen e dhunës dhe ndryshimin afatgjatë të sjelljes;
4. Të përdoret një klasifikim objektive dhe mbikqyrje e drejtpërdrejtë-të kyçet parandalimi i dhunës në procedurat bazë të klasifikimit dhe kontrollit të secilit institucion;
5. Të ndërpritet politika e mosndëshkimit-të fillohen proceset e rasteve të torturës nga ana e shërbimeve të sigurisë, dhe rastet e ndihmës joadekuate mjekësore.

### Në lidhje me kujdesin shëndetësor:

1. Të krijohet një komunikim më i mirë në mes të Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale me qëllim të përmirësimit të kujdesit të përgjithshëm shëndetësor të personave të privuar nga liria (sidomos në lidhje me vazhdimin e trajtimit pasi të burgosurit të lirohen).
2. Të pajisen burgjet shëndetësore me pajisje moderne dhe funksionale mjekësore që është e nevojshme në mënyrë që të sigurohet kujdesi adekuat shëndetësor për të gjithë të burgosurit.
3. Të rritet numri i punonjësve të shëndetësisë (mjekë dhe staf mjekësor) për të siguruar qasje më të mirë në shërbimet e kujdesit shëndetësor për personat e privuar nga liria.

4. Të mbrohen të burgosurit me sëmundje mendore. Të burgosurit me sëmundje mendore që do të i bëjnë ato veçanërisht të ndjeshme ndaj kushteve në paraburgim, duhet të vendosen në njësi të sigurta terapeutike. Objektet kanë nevojë për shqyrtim dhe vlerësim rigoroz të mjeteve që të sigurohet trajtim i duhur i të burgosurve të cilët janë edhe të sëmurë mendorë dhe të vështirë për t'u kontrolluar. Të garantohen shërbime psikologjike në të gjitha nivelet.

5. Të gjitha vendet e paraburgimit duhet të kenë personelin e nevojshëm, duke përfshirë edhe personelin mjekësor. Të sigurohet kujdesi për personat me sëmundje mendore; të identifikohen problemet mendore dhe të trajtohen personat me problem mendore në paraburgim.

6. Të punësohet stafi profesional (psikologët, terapistët, punonjës socialë, etj) i cili që do të siguronte asistencë të përditshme psikosociale dhe mbështetje për të gjithë personat e privuar nga liria.

7. Punonjësit e sigurisë nuk duhet të jenë prezent gjatë ekzaminimeve mjekësore të të burgosurve, vetëm në raste kur siguria e përgjithshme e personelit mjekësor është në rrezik. Në rastet e sigurisë të rrezikuar, është e nevojshme që të njoftohet autoriteti u burgut dhe të pregaditen raporte për të gjitha incidentet.

#### **Në lidhje me të drejtat e personave të privuar nga liria:**

1. Pavarësisht nga lloji i dënimit të shërbyer, të gjithë të burgosurit duhet të kenë të drejtën e një vizite të paktën një orë çdo javë.

2. Në institucionet ku kushtet materiale e lejojnë, duhet të sigurohet dhoma për vizitën e bashkëshortes/it.

3. Në institucionet ku kushtet materiale e lejojnë, duhet të sigurohen hapsira të ndara shtesë (vend për ceremonitë fetare, vend për avokatët, etj.);

4. Të burgosurit duhet të jenë në gjendje të përdorin të drejtën e tyre për një thirrje telefonike në secilën kohë të ditës (jo vetëm në një kohë të caktuar të ditës);

#### **Në lidhje me kufizimin e trajtimeve çnjerëzore:**

Trajtimi jo adekuat dhe çnjerëzore në burgjet mbetet një konstantë, sidomos kur është fjala për kujdesin shëndetësor. Rastet e listuara nuk janë duke marrë epilogun e tyre disiplinorë, pavarësisht nga fakti se në disa raste iniciativa erdhi nga shërbimet e sigurisë, administrues i besuar ose edukatorët për të zgjidhur rastet individuale. Siç është konfirmuar nga raportet e Avokatit të Popullit dhe të KPT-së, abuzimi i personave të marginalizuar të privuar nga liria, gjatë periudhës së kaluar 3 deri 5 vjeçare, dhe sjellja joadekuate e stafit shëndetësor në këto raste paraqesin arsye për shqetësim.

#### **Në lidhje me qasjet restorative:**

1. Promovimi i një kulture të respektimit të ndërsjellë. Të krijohet një kulturë pozitive në burgje bazuara në etikën e sjelljes me respekt dhe të komunikimit ndërpersonal nga e cila do të përfitojnë edhe të burgosurit dhe stafi;

2. Rekrutimi dhe mbajtja e një stafi të kualifikuar. Të miratohen ndryshimet në nivelin shtetëror dhe lokal për të përmirësuar rekrutimin dhe mbajtjen e cilësisë së lartë të fuqisë punëtore dhe zhvillimin e profesionalizmit;
3. Të sigurohet që zyrtarët e lartë, në selinë e administratës të burgut, dhe drejtorët e të gjitha institucioneve dhe menaxherët e tyre të lartë të posedojnë dhe të vënë në përdorimin e plotë kopjet e Këshillit të Rregullave Europiane të Burgut të Evropës. Gjithashtu, këto kopje duhet të mbahen të dukshëm në çdo bibliotekë të burgut për përdorimin nga të gjithë, si nga personeli tjetër i burgut ashtu edhe nga të burgosurit.

### **Në lidhje me shërbimet e sigurimit në burgje**

1. Të targetohen institucionet që janë në nevojë më të madhe të rritjes së numrit të të punësuarve në shërbimet e sigurisë dhe të hapet një konkurs për plotësimin e vendeve të punës për funksionimin më të lehtë dhe më të sigurt të objekteve të burgut;
2. Organizimi i kurseve të specializuara, trajnimi për punonjësit e shërbimit të sigurimit, të paktën një herë në vit;
3. Organizimi i kontrollave të rregullta mjekësore për punonjësit e shërbimeve të sigurisë.

### **Lidhur me pushtetin ekzekutiv:**

1. Të bëhet vlerësimi i organeve të brendshëm të inspektimit dhe përputhja e tyre me kërkesat e OPCAT;
2. Të kërkohet që të gjitha ligjet të cilat i referohen vendeve të paraburgimit të jenë në përputhje me legjislacionin e të drejtave të njeriut;
3. Të nxitet angazhimi i shoqërisë civile në vendimmarrje në lidhje me burg, zbatimin e ligjit, shëndetin mendor, dhe reforma të tjera nëpërmjet ngritjes së ekspertizës së përhershme.

### **Në lidhje me akterët e shoqërisë civile/monitorues**

1. Të vazhdohet me monitorimin e situatës së të drejtave të njeriut në vendet e ndalimit, si formë themelore për Parandalimin e Torturës;  
themelore për Parandalimin e Torturës;
2. Të inkurajohet angazhimi më aktiv i OJQ-ve në monitorimin e vendeve të ndalimit nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të OJQ-ve dhe nxitjes së rrjeteve në nivel rajonal dhe kombëtar;
3. Angazhim në mënyrë aktive në rritjen e ndërgjegjësimit mbi Protokollin Opsional të OKB-së bashkë me Komitetin kundër Torturës dhe lobim për përgjegjësi dhe transparencë në të gjitha vendet e privimit të lirisë.



## V QASJE RAJONALE DHE REKOMANDIMET MBI FUSHAT ME INTERES

Duke krahasuar fushat e shqetësimit në tre vendet e analizuara, mund të vërehen më shumë se një ngjashmëri. Disa prej tyre janë shkaktuar nga fakti se procesi i reformës, si ai i kornizës ligjore dhe i qasjes ndaj torturës dhe trajtimit tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtërues, ose ndëshkimit ka filluar me ndryshimet demokratike në fund të vitit 1990 ose në fillim të vitit 2000 dhe mund të thuhet se ajo është ende në fazën fillestare në të gjitha vendet. Mungesa e burimeve financiare për stafin adekuat dhe renovimin adekuat të objekteve mund të veçohet si një nga arsyet, por kjo nuk duhet të përdoret si një justifikim për mungesat e tjera në sistemin e parandalimit të torturës.

Ngjashmëritë gjithashtu vijn nga fakti se metodologjia e përdorur nga MKPT dhe aktorët e tjerë për monitorimin e gjendjes së burgjeve dhe njësive të paraburgimit janë gati të njëjta dhe të rregulluar në nivelin ndërkombëtar dhe rajonal, sidomos duke pasur parasysh se të gjitha këto vende e kanë përshtatur politikëne e vet me *acquis communautaire* BE në këtë fushë gjatë procesit të integrimi të BE-së, dhe ata të gjithë kanë misione të rregullta ndërkombëtare të vëzhgimit, të tilla si vizitat e KPT-së.

Bashkëpunimi rajonal i MKPT-ve, shoqërisë civile dhe administrative të burgjeve është çelësi për zhvillimin e luftës kundër torturës dhe trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, apo dënimit në rajon.

Rekomandimet, të ndarë në segmente të ndryshme në secilin prej raporteve të vendeve, gjithashtu mund të aplikohen në kontekstin rajonal. Specifikat mund të shihen në nivelet e aktiviteteve dhe efektivitetit të sistemit MKPT në secilin prej vendeve, si dhe në rolin e shoqërisë civile në monitorimin dhe raportimin. Në këtë kuptim, rekomandimet nga një vend do të mund lehtë të aplikohen në dy vendet e tjera si dhe në rajon në tërësi.

Kjo gjithashtu konfirmon se qasja rajonale që ne kemi zgjedhur është jo vetëm e vlefshme, por edhe më efikase dhe mbështetëse për formimin e një përgjigjeje të përbashkët ndaj torturës dhe trajtimit tjetër mizor, çnjerëzor dhe degradues ose ndëshkimit.